



## T R A N S K R I P T

**I mbledhjes së katërt të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 03.05.2018, me fillim në orën 10:00.**

**Kryesuesi Agim Kuleta:** Po fillojmë me seancën, ku është zilja? Kjo zile nuk është kah bënë. Atëherë konstatojmë që kemi kuorum janë 41 të pranishëm, dhe mund të fillojmë me punën e Kuvendit.

Ju lutem për qetësi, ju lutem për qetësi,

Atëherë para se të fillojmë me diskutimin për rendin e ditës, dua të ju njoftoj që prej rendit të ditës i cili ju ka ardhur juve më herët, me kohë do të thotë ka, një ndryshim, është paraqitur një kërkesë urgjente nga FSK-ja dhe nga KFOR-i për ndarjen e një hapësire për ngritjen e një obelisku për ushtarët e KFOR-it që kanë vdekur në Kosovë. Dje është mbajtur një mbledhje urgjente e KPF-së, dhe është miratuar propozimi që të futet si pikë e rendit të ditës për mbledhjen e sotme. Prandaj për diskutim e hap rendin e ditës, të cilin e keni sot para jush, me këtë plotësim, pra në pikën e dytë.

Atëherë e hap diskutimin.

Egzon Azemi.

**Egzon Azemi:** Faleminderit kryesues.

Kisha kërkuar që edhe për ndërmarrjet publike të jetë një pikë e veçantë e rendit të ditës. Faleminderit.

**Kryesuesi:** Atëherë e kemi propozimin që ndërmarrjet publike të futen si pikë e rendit të ditës, po duhet me e precizuar si formulim.

**Egzon Azemi:** Gjendja aktuale e ndërmarrjeve publike, besoj që është më precize tash, ka shumë është debat tepër i gjërë, kryesisht çka unë dua me ngrit është aty ku edhe vetë jam aksionar te Ndërmarrja publike banesore, mirëpo nuk e dimë gjendjen e ndërmarrjeve tjera. Nuk kemi bërë asnjë diskutim asnjëherë këtu në asamble për ndërmarrjet publike, kështu që besoj që është shumë e vlefshme me e bërë një diskutim për këtë çështje.

**Kryesuesi:** Po atëherë është e rregulluar kjo çështje që një herë në vit të raportojnë aksionarët e ndërmarrjeve publike, mirëpo nëse ju kërkoni që të futet si çështje urgjente për ta diskutuar, si pikë e rendit të ditës, ne jemi të obliguar ta vendosim në votim këtë propozim, dhe të marrim qëndrimin e Kuvendit.

Po Egzon.

**Egzon Azemi:** Z. kryesues, unë e di ti je shumë i vetëdijshëm çka ka ndodhur deri sot në muajt e fundit të paktën për Ndërmarrjen publike banesore. Kështu që një pikë e rendit të ditës është më e pakëta çka ishte dashur me u bërë, nëse jo unë atëherë është dashur me e bërë ti, sepse ke kompetencë edhe vetë me e futur si pikë të rendit të ditës, të paktën edhe me e diskutuar fare me neve, për shkak që kanë ndodhur disa probleme në Ndërmarrjen publike banesore. Po gjithashtu nuk është që ka lajme të mira edhe te ndërmarrjet tjera, kështu që besoj që është shumë e rëndësishme ta shtimë si pikë të rendit të ditës dhe të diskutojmë për këtë.

**Kryesuesi:** Për të gjitha ndërmarrjet apo veç për Ndërmarrjen publike banesore?

**Egzon Azemi:** Për të gjitha ndërmarrjet publike mendoj për të gjitha ndërmarrjet.

**Kryesuesi:** Gjendja aktuale në ndërmarrjet publike.

Në rregull.

Atëherë a ka dikush tjetër.

Leutrim Retkoceri.

**Leutrim Retkoceri:** A po flasim për pikat e rendit të ditës, apo për pikën e veçantë urgjente të rendit të ditës, kërkesën?

**Kryesuesi:** Kërkesë është me u shtuar edhe një pikë e rendit të ditës, si çështje urgjente me u trajtuar sot çështja e ndërmarrjeve publike.

**Leutrim Retkoceri:** OK, do të thotë për këtë pikë a duam me fol, apo për të tjerat?

**Kryesuesi:** Jo tash ideja është jemi duke folur për propozim, pa e përfunduar këtë çështje mos të hapim tjera, pra ta qesim në votim, nëse ke diçka lidhur me këtë pikë në rregulle? Nëse jo...

**Leutrim Retkoceri:** Po, unë desha me diskutuar për këtë. Është i mirëpritur propozimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e obeliskut për pjesëtarët e KFOR-i dhe të NATO-së, mirëpo ne e kemi ngritur edhe në seancat paraprake një çështje, sheshin Adem Jashari dhe propozimin për vendosjen e bustit të sheshit Adem Jashari. A duhet KFOR-i dhe NATO me na bërë ndonjë kërkesë urgjente për me e caktuar sheshin dhe shtatoren e Adem Jasharit, apo veç kur të na thonë të huajt, na me i shti në seanca të jashtëzakonshme, edhe me i përkrahur? Të jemi të qartë, na e përkrahim këtë pikë, mirëpo mos të tregohemi kaq servil krahasuar me vlerat e huaja e ti nënvlerësojmë vlerat tona, ky është komenti im sa i përket kësaj pike. Faleminderit.

**Kryesuesi:** Në rregull.

Atëherë procedurat dihet qysh janë për me u bërë një rend i ditës, secili mendoj e ka mundësinë ose të thërret seancë të jashtëzakonshme, ose të propozoj të futet pikë e rendit të ditës, gjendja është kjo që është.

Dikush tjetër rreth pikës së propozuar nga Egzoni?

Po.

**Sami Boroci:** Përshëndetje të gjithëve.

I nderuari kryesues.

Nënkryetar;

Drejtorë;

Asamblistë.

Në lidhje me propozimin e Egzonit, ose kolegut nga VV-ja, unë personalisht i kam pa raportimet e fundit që nuk ka pas gjendje shumë të mirë qoftë në Ndërmarrjen publike

banesore, qoftë në ndërmarrjet tjera, mirëpo na i kemi caktuar aksionarët në këto ndërmarrje dhe besoj shumë që ata janë veç në procedurat e kompletimit, ose funksionalizimit të bordeve dhe zgjedhjet tjera të organeve të nevojshme. Unë personalisht mendoj që pa pas një material, veç me raportime të mediave, nuk do të duhej që sot ne të diskutonim diçka të tillë. Mundemi me e thirr një seancë urgjente, edhe unë jam për me i trajtuar ndërmarrjet publike komunale, mirëpo pa një material të qartë veç me raportime të mediave, unë personalisht propozoj që kjo mos me hy si pikë e rendit të ditës.

**Kryesuesi:** Faleminderit.

Agim Gashi.

**Agim Gashi:** Faleminderit kryesues.

Përshëndetje për të gjithë.

Jo pse kjo kërkesë është e pa arsyeshme, unë mendoj që jo vetëm kjo temë, po ka disa tema që mjaftë bazike për të cilat ne në Kuvend duhet të diskutojmë, por nuk e konsideroj se kjo pikë e rendit të ditës,

**Kryesuesi:** Fadil ta dëgjojmë kolegun.

**Agim Gashi:** Meqë është mjaft komplekse, mendoj që për sot nuk jemi të përgatitur të diskutojmë, dhe nëse pajtoheni propozoj që kjo pikë të jetë në seancën e rregullt të ardhshme, jo të jashtëzakonshme, për arsye se pesha e temës është mjaftë e rëndësishme. Ne edhe ashtu kemi nevojë që brenda këtij muaji ta mbajmë seancën e muajit maj, se kjo është e muajit prill që po diskutojmë sot, dhe nuk bëhet vonë pas dy-tri javëve kur ju jeni të gatshëm ta planifikojmë, ta fusim dhe të diskutojmë për ndërmarrjet publike, se ka mjaftë çka të diskutohet.

Faleminderit.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë.

Diskutime tjera?

Nuk ka.

Atëherë e hedhim në votim.

Po, po.

**Leutrim Retkoceri:**..(Jashtë mikrofonit) Kolegut për futjen në rend të ditës të kësaj pike, unë mendoj që problematika e Ndërmarrjes publike banesore nuk duhet me u trajtuar nga fakti se sa kanë probleme atje aksionarët, por duhet me u trajtuar në bazë të ligjit besoj qysh është e përcaktuar. Duke e pas parasysh një transparencë dhe një llogaridhënie më të madhe, dhe unë mendoj që duhet ta vendosim në një ditë të veçantë këtë temë, ta trajtojmë në formën më të mirë, mirëpo jo për shkak se kolegu Egzon tha e këna një problem atje në Ndërmarrjen publike banesore. Nuk jena këtu për probleme, që kanë probleme personale personat atje në fjalë, por jena këtu për interes të qytetarëve, me ua trajtuar qytetarëve problematikat me të cilat përballen çdo ditë, që unë mendoj që ndërmarrjet publike luajnë një rol të veçantë në mirë funksionimin e jetës së tyre, ky është qëllimi.

**Kryesuesi:** Faleminderit.

Egzon si propozues dhe po e mbyllim debatin

**Egzon Azemi:** Faleminderit.

Atëherë propozoj që këtë pikë të rendit të ditës ta shtyjme për seancën tjetër të ardhshme të rregullt, se nuk po besoj që kemi nevojë me thirr mbledhje të jashtëzakonshme ose urgjente për këtë çështje, por e shtyjme për seancën e ardhshme për shkak që me pas kohë me u

përgatitur. Mirëpo arsyeja pse desha me e ngritur këtë çështje është se të paktën në Ndërmarrjen publike banesore, nuk është kjo as çështje që është përmendur veç në media qysh tha Samiu, as qysh po e bënë Leutrimi që aty janë disa probleme në mes të disave, mirëpo për këtë çështje ekziston tashmë edhe një interpretim i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, përkatësisht Njesisë për monitorimin e ndërmarrjeve publike, e cila ka vërtetuar se në vendimin që e kanë marrë dy nga aksionarët, njëri i caktuar nga kryetari Shpend Ahmeti dhe tjetri i zgjedhur nga asambleja, ka shkelje ligjore, prandaj kjo është çështje shumë serioze dhe nuk është një problem i vogël qysh jeni duke e trajtuar. Shpresoj që në seancën tjetër të futet si pikë e rendit të ditës, dhe vazhdojmë diskutimin.

Faleminderit.

**Kryesuesi:** Vala është lajmëruar, po ky e tërhoqi tash nuk e di a ka arsye se e tërhoqi si pikë, ndërmarrjet publike po.

Faleminderit.

Atëherë e kemi rendin e ditës, i cili ka ardhur sot me futjen e një pike tjetër shtesë.

E hedhë në votim rendin e ditës komplet.

Edhe njëherë regjia të lutem, propozim tjetër Eman Rrahmani.

**Eman Rrahmani:** Ne si grup i LVV-së nuk kemi përfaqësues në KPF, kështu që propozoj si pikë e rendit të ditës të jetë edhe emërimi i dy anëtarëve në KPF, për shkak se në bazë të formulës e cila është përdorur deri më tash për ndarjen e anëtarëve, na takojnë dy anëtarë, dhe fatkeqësisht na gjithë këto pika që i kemi i shohim veç kështu në letër, nuk kemi qenë as pjesëmarrës në komitet, dhe për këto pika po mendoj që për neve është më e vështirë me i diskutuar dhe me i ...(Fjala e pa përfunduar).

**Kryesuesi:** Me radhë Leutrim Retkoceri është, ose jo më falë veç pak se po shkojmë me GP. Halim Halimi, më fal.

**Halim Halimi:** Lidhur me propozimin e LVV-së për shtimin e dy anëtarëve në KPF, sipas formulës janë caktuar anëtarët e KPF-së, nëse shkojmë sipas formulës, atëherë edhe LDK-ja do të duhej të shtohet, nëse shkojmë sipas formulës. Por unë po mendoj që janë zgjedhur njëherë anëtarët e KPF-së, është çështje e grupit të juaj me grupin tjetër me u marrë vesh, se ju i keni fituar ato vende kur keni qenë bashkë, dhe nuk ka lëvizur kurrëgjë në atë drejtim. Jeni ata që jeni, ju merreni vesh me Grupin e pavarur, sa i kanë unë tash nuk e di, prej tyre mund të kërkonit që në atë numër ju me participuar, po. Përndryshe KPF-ja i ka 11 anëtarë, ai as nuk bëhet me 12, as me 13, e ju po, ju në mes veti merruni vesh, përndryshe nëse diçka tjetër, ne kërkojmë shtimin edhe të një anëtari tjetër.

Faleminderit.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë.

Ideja është 2 me 2 me qenë, d.m.th. me u zëvendësuar aq sa i kanë pas nuk rritet numri, veç zëvendësim, ani de se është e përcaktuar.

Leutrimi njëherë nëse donë prej grupit tjetër?

Nuk e ka kërkuar fjalën por gabimi im ka qenë, le të përgatitet Shefki Gashi.

**Leutrim Retkoceri:** I nderuari kryesues sa i përket propozimit për këtë pikë të rendit të ditës, edhe njëherë ne i kemi marr propozimet për pikatë e rendit të ditë që janë sot, dhe unë po shoh që seanca po kalon prej agjendës në problemet në mes të dy grupeve atje. Ata janë votuar do të thotë anëtarët në KPF dhe defakto janë ata për momentin. Ligji e përcakton

kështu, përndryshe derisa të merren ata vesh, le të merren vesh në mes veti, mirëpo jo sot ta ngarkojmë këtë seancë me propozimin e këtyre pikave që as vetë se dinë se qysh i bien më tamam. Unë veç edhe një pyetje e pata kryesues: A po vazhdojmë edhe kësaj radhe si radhëve të kaluara që pyetjet me u bërë në fillim të pikave të rendit të ditës, apo po kalojmë te e dhjeta qysh është e caktuar me pika të rendit të ditës?

**Kryesuesi:** Faleminderit Leutrim.

Po më duket nuk u sqarua mjaftueshëm kjo puna e KPF-së, pra, këta e kanë të qartë kanë bërë marrëveshje e dinë kush është, është çështje thjeshtë duan me e shti si pikë të rendit të ditës zëvendësimi i anëtarëve që janë me anëtarë tjerë, pra nuk ka problem ata janë marrë vesh, është e kryer, veç po duan me e futur si procedurë për me u votuar kjo çështje, se tash është mbledhja e radhës e KPF-së, dhe duan me pas përfaqësim aty.

Shefki Gashi.

**Shefki Gashi:** Faleminderit.

Përshëndetje për të gjithë.

Dëgjoni, këtu ka ndryshuar një realitet, këta janë ndarë, janë dy gupe tash, ndoshta këtij shefit tonë nuk ju kujtuar, duhet të ndryshojnë edhe sendet tjera, jo veç anëtarët e KPF-së. Natyrisht ata nuk rriten, por ata ndahen në bazë të numrit të anëtarëve në asamble që i kanë, por tani është grupi i parë në Kuvend LDK-ja. Ne e kemi pas atëherë si traditë përpara grupi më i madhe i partisë politike është ulur në atë krahun atje, dhe tash duhet për me i ndarë këto si grupe, si kundërshtarë që tash janë deri sa të rrafshitën pakë, le të dalin këta këndej dhe të fokusohen në një grup të dy grupet, që mos të janë të përzier kështu, dhe ne dalim në pozicionin që e kemi për momentin.

Faleminderit.

**Kryesuesi:** Adrian vetëm një sekondë, se po dua një informim me e bërë, pastaj ndoshta e sqaron këtë situatë. Grupi që është caktuar për plotësim dhe ndryshim të rregullores, ka punuar në këtë drejtim dhe aty është si propozim që ka pas përkrahje d.m.th. veç LDK-ja nuk ka qenë aty, por do të vazhdojmë punën edhe këtu në Prishtinë, do ti shqyrtojmë të gjitha ato edhe njëherë. Ka dal propozimi që si vend kryesor që mendojmë edhe e ka logjikën me u trajtuar kjo pjesë, se kryet e vendit te dera diqysh, nuk e di qysh ka mbetur si praktikë, po realisht pozita, vendi kryesor është ky. E atëherë nëse vendoset kështu dhe vendoset që LDK-ja me qenë këtu, atëherë nuk ka nevojë me lëvizur prej vendeve, kjo është arsyeja pse nuk e kemi trajtuar, por do të vjen rregullorja, miratohet rregullorja dhe në përputhje me te i marrim edhe hapat e mëtutjeshëm.

Adrian Berisha.

**Adrian Berisha:** Përshëndetje të gjithëve.

Mua sinqerisht po më vjen keq çfarë debati jemi tu bërë njëri me tjetrin këtu, është marre me u mbledhur një herë në dy muaj dhe me diskutuar për problematika të tilla. Duke e marrë parasysh që qytetarët na kanë zgjedhur neve me punuar punë të cilat duhet me i kryer na këtu, e ato punë d.m.th. i kemi në pikat e rendit të ditës, dhe kishte me qenë mirë me filluar me diskutuar për ato pika, pra, kemi sa të duash punë në qytet për me bërë edhe me diskutuar d.m.th. ky, ai, ajo, po më duket shumë e pahijshme.

Faleminderit.

**Kryesuesi:** Faleminderit Adrian.

Atëherë është propozimi për zëvendësimin, kanë marrëveshje është e logjikshme, është e ligjshme, atëherë veç duhet me e futur si propozim me e votuar formalisht realisht.

Kush është për që të futet ky propozim për zëvendësimin e anëtarëve në KPF?

Regjia,

Atëherë 24 vota janë për.

Kundër 5 vota, dhe

4 abstenime.

### **Futet si pikë e rendit të ditës para pikës pyetje dhe përgjigje d.m.th. në fund të rendit të ditës.**

Atëherë regjia gati e hedhim në votim komplet rendin e ditës.

Jo nuk pati propozim, jo, jo nuk pati, ai veç pyeti kur ka me qenë.

**Leutrim Retkoceri:**...(Jashtë mikrofonit), të përgjithshëm që pyetjet dhe përgjigjet me qenë pika e parë e rendit të ditës, pastaj me vazhduar me pikat.

**Kryesuesi:** Ka qenë vendimi vetëm për atë seancë,

**Leutrim Retkoceri:** Vetëm për atë seancë, po nëse ka unë kisha me propozuar që me qenë apert propozimi tjetër...,

**Kryesuesi:** Leutrim, kjo realisht është shmangie prej Rregullores, atë ditë kemi votuar për shmangie prej rregullores, se në rregullore të punës parashihet rendi i punëve ku pika pyetje dhe përgjigje është në fund të listës të punëve që do të duhej të kryhen. Pra, atë ditë kemi votuar për shmangie prej rregullores, përndryshe duhet me votuar për çdo seancë për me dal në fillim. Përveç kësaj e hedhim në votim por unë me të thënë të drejtën krejt ato reagimet që kanë qenë prej asamblistëve, kanë qenë të pakënaqur, sepse pikat kryesore të rendit realisht mbeten pa u diskutuar siç duhet, për shkak të kohës që e morën pyetjet dhe përgjigjet. Si të doni, unë në votim e qes sepse nëse është propozim jam i obliguar me e qit në votim, po nuk po më duket shumë e arsyeshme.

**Leutrim Retkoceri:** Kryesues megjithatë se ne po dalim, po shmangemi prej rendit të ditës, unë mendoj që është me rëndësi dhe e kemi diskutuar në parim, për shkak se shumicën e drejtorëve na këtu nuk po i kemi në pikën e dhjetë të rendit të ditës ku janë pyetjet dhe përgjigjet, kujt me i bërë pyetje na? Realiteti është ky unë kisha propozuar që...

**Kryesuesi:** Është propozim, pra me dalë pika pyetje dhe përgjigje.

Halim Halimi.

**Halim Halimi:** Këtë na e pamë edhe në mbledhjen e kaluar çka është me e qit në fillim, pra, pikën pyetje dhe përgjigje, deri në orën 13:00 mbetëm te pika pyetje dhe përgjigje, atëherë pikat që i kemi këtu e që janë shumë më të rëndësishme, po na mbetin kah fundi, po lodhemi dhe nuk po kanë kurrfarë efekti. Kështu që propozoj, propozim i imi është që pika pyetje dhe përgjigje të bëhet në fund, dhe e kisha lut kryetarin që nuk po vjen po qenka nënkryetari këtu që drejtorët me i obliguar, bile ata që i kanë pikat e rendit të ditës me prezantuar në mbledhje të Kuvendit, gjithsesi ai që ka pikë të rendit të ditës, ai duhet me qenë në mbledhje të Kuvendit, bile ata. Kështu që këtë çështje nuk kemi nevojë me e diskutuar, pra nuk jam për me e qit pikën pyetje dhe përgjigje në fillim.

Faleminderit.

**Kryesuesi:** Faleminderit.

Vala Peshku.

**Vala Peshku:** Mirëdita të gjithëve më së pari.

Kështu, më sa e di në Grupin punues për Rregulloren e Kuvendit është diskutuar kjo puna e pyetjeve dhe përgjigjeve, edhe meqenëse më sa e di në mbledhjen e ardhshme kemi me e pas më të qartë se si ka me qenë kjo procedurë, prapë mendoj që duhet me mbet si pikë e fundit për arsye se si pikë e parë deri tash ka qenë absolut jo produktive, sepse ekzekutivi nuk ka qenë fare i përgatitur për pyetjet dhe përgjigje që i kemi pas, dhe asgjë nuk kemi qit në dritë me ato pyetje dhe përgjigje, përveçse do elektricitet që ka lind këtu me fjalë duke u gjuajtur këtu poshtë e lartë.

**Kryesuesi:** Faleminderit.

Eman Rrahmani.

**Eman Rrahmani:** Pak me thënë të drejtën u habita qysh po thonë kemi mbetur deri në dy, kemi ardhur për atë punë me ndej deri në dy e deri në katër e me i kryer punët që na takojnë, jo me e këqyrë orën sa kalon dhe sa bëhet aty. E përkrahi propozimin për me dal si pikë e parë e rendit të ditës. Unë e pash edhe në Parlament të Kosovës, këto janë pikat e para çdoherë që diskutohen, për shkak që edhe d.m.th. prezenca, edhe mundësia e marrjes së përgjigjes, dhe e pamjes më me efikasitet të punës është kjo, përndryshe të tjerat nuk po besoj se qëndrojnë.

**Kryesuesi:** Leutrim pas pak, veç Nol Nushi, pasi që je propozues, po po, pasi që je propozues fole në fillim, tash grupet shkojnë me radhë.

**Nol Nushi:** Mendoj që këto krahasimet me Parlament të Kosovës nuk vlejné hiq, edhe jemi duke e bërë në çdo seancë, duke ia dhënë vetit do kompetenca që nuk i kemi. Pyetjet që iu drejtohen drejtorive ne e dimë çdo ditë munden me shkuar me shkrimë dhe me marrë përgjigje, nëse është ideja me bërë shou ne e qesim pikë të parë dhe flasim edhe për sende që nuk ekzistojnë hiq, po veç për me fol, se mediat janë këtu në fillim. E kuptoj që po iu intereson me dal në televizion disave, por po e shoh pak si problem, se nuk jemi me dal në televizion, por jemi me zgjidh punë, edhe kjo pika pyetje përgjigje në fakt nuk është që zgjidh ndonjë send përpos që na ofron mundësinë me dal në televizion, se përgjigjen e njëjtë mundemi me e marrë edhe prapa dyerve të këtij Kuvendi, edhe dje, edhe pardje, edhe gjatë tërë muajit, por ne po i ruajmë pyetjet me gjasë veç për seancë se duhet me dal në televizion. Kështu që mendoj se pika pyetje dhe përgjigje është më shumë për ndonjë çështje e cila nuk po mbërrin me marr ndonjë përgjigje të madhe e duamë me e bërë pak më mediatike. Përndryshe për çdo ditë të lume, në Kuvend të Prishtinës mundemi me i pyetur drejtorët qoftë individualisht, qoftë me kërkesa zyrtare. Mendoj që sa më pak me eliminuar këtë pjesën e shout televiziv, dhe me qenë më efikas dhe më konkret, brenda kompetencave që i kemi si këshilltarë komunal.

Faleminderit.

**Kryesuesi:** A biem dakord diçka do të thotë, se në emër të GP folën realisht secili, e dhanë qëndrimin e vetë, a e qesim në votim si propozim dhe të ecim? Ta bëjmë më racionale se po na shkon dita me diskutime kështu. Veç nëse e tërheqë Leutrim, se përndryshe, vetëm nëse e tërheq, OK.

Urdhëro Leutrim.

**Leutrim Retkoceri:** Unë pikësëpari kryesues desha veç nja dy përgjigje të shkurtra për ngritësit e temës se a duhet me qenë pikë e parë e rendit të ditës, apo jo.

**Kryesuesi:** Veç në replikë mos të ketë, mos të na shkon dita se kemi tema shumë të rëndësishme, e kemi raportin etj.

**Leutrim Retkoceri:** Jo, jo absolut jo replikë e qartë që kemi tema të rëndësishme, mirëpo z. Halim tha se po lodhemi me mbet në seancë deri në orën 2-3. Një herë në muaj kemi seancë dhe kushdo që lodhet le të shkon në shtëpi, edhe LDK-në elektorati e ka qar në shtëpi, se u pat lodhë, veç pak. Vala e përmendi tha nuk po janë të përgatitur drejtorët me japë përgjigje, po tregon më së miri që kemi drejtor që do të thotë nuk janë duke e kryer punën mirë.

**Kryesuesi:** Leutrim eskaloj diskutimi, ju lutem vetëm nëse donë me e tërheqë ose me vazhduar, se nuk.

**Leutrim Retkoceri:** Kryesues të lutem mos më ndërpre se...,

**Kryesuesi:** Jo, jo duhet me të ndërpre sepse ke propozime dhe kjo tash është veç replikë, replika në rend të ditës është e tepërt tash

**Leutrim Retkoceri:** Jo replikë, unë po them tash si propozues kryesues,

**Kryesuesi:** Po dua me e hedhë në votim dhe kush është për mirë, kush është kundër.

**Leutrim Retkoceri:** Le të fol, pasi nuk është kryetari le të fol nënkryetari nëse qëndrojnë drejtorët këtu deri në pikën e dhjetë të rendit të ditës, unë jam i gatshëm me e tërheq propozimin, krejt ideja është këta me qëndruar dhe pyetjet ne me ua bërë drejtorëve.

**Kryesuesi:** Atëherë regjia ju lutem gati për votim.

Është propozimi që pika pyetje dhe përgjigje të del në, vetëm një sekondë.

(Diskutuesi jashtë mikrofonit)

**Kryesuesi:** Po de, po tash kjo është replikë, veç një sekondë, në rregull ne gjithë ditën mund të flasim për këtë punë, në rregull.

(Diskutuesi jashtë mikrofonit)

**Kryesuesi:** Në rregull,

Atëherë regjia ju lutem gati për votim që të futet si pikë e tretë e rendit të ditës, pas obeliskut se kjo është më urgjente, duhet me filluar procedurat.

Gati për votim.

Votojmë tash.

Për 18 vota,

Kundër 25 vota.

1 abstenim.

**Nuk futet si pikë e tretë e rendit të ditës.**

Atëherë shkojmë e votojmë komplet rendin e ditës.

Regjia gati.

Votojmë tash.

Faleminderit shumë.

**Me 39 vota për, 2 vota kundër, asnjë abstenim miratohet rendi i ditës i mbledhjes së sotme.**



## Pika e parë

### **Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.**

**Kryesuesi:** Atëherë nuk ka, Vesel Makolli më fal atëherë,

**Vesel Makolli:** E kemi përpara ekstraktin e mbledhjes së marsit, d.m.th. mbledhjes jo të fundit, por të parafundit, kjo praktik po vazhdon që me marrë me dy mbledhje vonesë ekstraktin. Andaj unë mendoj që ne duhet ta kishim pas sot ekstraktin e mbledhjes së fundit, dhe propozoj që kjo praktik në të ardhmen të jetë që ekstrakti të jetë i mbledhjes së fundit, sepse nuk e di se sa ka kuptim me e marrë dy mbledhje prapa. Mendoj që mundet kjo punë me u azhuruar, nuk është ku me ditë çfarë pune e madhe, na edhe ashtu po kemi mbledhje njëherë në muaj, kështu që mundeni me e përgatit ekstraktin e mbledhjes së fundit. Faleminderit.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë.

Është e vërtetë kjo çështje, po një prej arsyeve që po vonohen ekstraktet është edhe për shkak të mungesës së stafit me të thënë të drejtën, është një lektor për krejt komunën për çdo çështje, prandaj kjo çështje duhet të zgjidhet ndoshta me rritjen e numrit të njerëzve që merren me lekturë dhe me proceset tjera, kjo është arsyeja, e kemi edhe ne këtë vërejtje, besoj që shpejt do të rregullohet.

Faleminderit.

Atëherë regjia gati për votim.

Votojmë tash.

### **Me 38 vota për, asnjë kundër dhe 2 abstenime, miratohet ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së dytë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.**

## Pika e dytë

### **Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e Obeliskut në përkujtim të pjesëtarëve të KFOR-it dhe të NATO-së.**

**Kryesuesi:** E hap diskutimin.

Atëherë nuk ka diskutues të paraqitur, apo ka.

Leonora Shabani-Bajraktari.

**Leonora Shabani-Bajraktari:** Përshëndetje të gjithëve.

Në fakt para 5 minutave më ka ardhur, për herë të parë e pash këtë dokument, dhe nuk kam mujt me e lexuar krejt, tash nuk e di tamam se çka përmban kjo, a mos është diçka edhe në dëm të qytetarëve, kështu që momentalisht unë kisha dashur bile pak kohë sa i përket votimit të aprovimit të këtij Obelisku. Atëherë e kisha lënë që votimi të jetë më vonë derisa ti marrim informatat tamam, ta lexoj tamam të gjithë materialin që na është dhuruar në zarf.

Faleminderit.

**Kryesuesi:** Po faleminderit shumë.

Thash që ka qenë çështje urgjente, që është trajtuar në KPF, mirëpo e konsideroj të rëndësishme që të sqarohet edhe për anëtarët tjerë të Kuvendit, prandaj e ftoj drejtorin që ta sqaroj, si çështje. Po veç tash drejtori le ta sqaron për të gjithë, e mandej e vazhdojmë me gupe.

Drejtor të lutem.

**Genc Bashota:** Faleminderit kryesues.

Atëherë para nja pesë ditëve unë e kam pas një takim me Ministrinë e Mbrojtjes dhe përfaqësuesit e KFOR-it, disa gjeneral prej tyre, të cilët një kohë pak më të gjatë kanë hulumtuar për lokacionin lidhur me Obeliskun e ushtarëve të KFOR-it të rënë gjatë misionit 17 vjeçar a sa janë bërë deri tash, edhe e kishin me rëndësi që me 12 qershor me e promovuar këtë Obelisk. Dizajnin e ka kryer KFOR-i, do të thotë edhe instancat e kësaj çështjeje sa i përket dizajnit të pllakës kishin shkuar deri në Bruksel në Komitetin e NATO-së dhe e kanë vendosur këtë dizajnë të cilin e kanë propozuar, dhe e keni aty në material. Sa i përket lokacionit, dy lokacione kanë qenë do të thotë me interes për ta, njëri afër ATK-së ku është sot objekti apo ish Shtëpia e mallrave e vjetër, meqë rast ne po mendojmë aty me e bërë Sallën koncertale, jemi në bashkëpunim me Komisionin Evropian me e marrë një grant të madh d.m.th. rreth ndërtimit të sallës, kështu që ajo ra prej opsionit. Kështu që i vetmi opsion i cili ishte i mundshëm dhe kështu i pranueshëm për të dy palët, ishte ky që e keni këtu, do të thotë në Sheshin “Nëna Terezë”, pak më poshtë se përmendorja e “Nënës Terezë”, aty ku shiten lulet përball “Ringsit”, prona është e komunës, është në harmoni me planifikim, nuk ka kurrfarë telashe, dhe opsion tjetër nuk kemi. Përndryshe atyre është duke iu ngutur kjo çështje, për arsye se më 12 qershor kanë me e thirr një numër të madh të delegacioneve nga gjithë bota, për me e promovuar këtë Obelisk. Kjo është çështja, nëse ka ndonjë pyetje tjetër, jemi këtu me e sqaruar.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor.

Halim Halimi.

**Halim Halimi:** Ne e patëm dje edhe në KPF, bile aty nuk pati nevojë me dhënë sqarime kurrkush, kështu që e kemi lexuar vendimin, na edhe e kemi analizuar, pa kurrfarë hezitimi, pra, ne do të jemi pro caktimit të atij lokacioni për vendosjen e Obeliskut në përkujtim të pjesëtarëve të KFOR-it dhe të NATO-së, bile unë mendoj që kjo është më së paku që na mund të bëjmë. Kështu që unë kisha propozuar por nuk kam të drejtë me ia ndal kurrkujt diskutimin, e as ju, po mos të diskutojmë, mos të replikojmë këtu, po ta qesim në votim dhe kjo le të shkon menjëherë, mos të humbim kohë rreth kësaj çështjeje.

Faleminderit.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë.

Prej grupeve parlamentare Vesel Makolli është paraqit.

**Vesel Makolli:** Edhe ne gjithashtu e përkrahim, edhe pa kurrfarë vërejtjeje, prandaj edhe unë propozoj që me e qit menjëherë në votim, mos të humbasim kohë.

**Kryesuesi:** Tash secili e ka të drejtën për diskutim.

Migjen Shala.

**Migjen Shala:** Faleminderit kryesues.

Përsëendetje për të gjithë kolegët.

GP i PDK-së në parim e përkrah këtë, mirëpo një fjalë popullore thotë: “Kur nuk je për të tëndin, nuk je as për tjetërkënd”. Ne qe 10 vite u miratuar këtu në Kuvend Komunal të

Prishtinës për shtatoren e Adem Jasharit, ku është qeverisja komunale, ku është kryetari i komunës, ku je nënkryetar, atë ditë je zotuar disa llafe. Ju kisha lut që të kihet parasysh Sheshi "Adem Jashari" dhe shtatorja, na nuk jena kundër, Adem Jashari ka vdekur për këtë vend me familje, kurse këta kanë humbur jetën aksidentalisht. Ne jemi për obelisk, jemi për, nuk është për të qeshur z. Halimi, mos e sill kokën, se ti ke qenë kryesues, ti ke qenë në asamble gjithë këtu, u marrë vendimi i përbashkët për sheshet "Adem Jashari" dhe "Ibrahim Rugova". Keni punuar njëanshëm, e keni ndreq sheshin "Ibrahim Rugova", krejt në rregull është nuk ka kurrgjë kundër, e ke lënë sheshin "Adem Jashari", pse? Që ka vdekur me 52 anëtarë të familjes a? Për atë e keni lënë, kjo nuk është në rregull. Ne jemi për obeliskun, do të votojmë për, mirëpo ka qenë e rrugës kryesues, nënkryetar, jeni prezentë ju kisha lutur për sheshin "Adem Jashari" ta mbajmë një seancë, të këqyrim çka po bëjmë, çka kemi mundësi të bëjmë në mënyrë ligjore ti rregullojmë këto sende, jo, jo, t'ia heqim këtij sheshi emrin "Adem Jashari". Nuk shkon aty monumenti jugosllav i ish sistemit komunist dhe i bashkim-vëllazërimit me shtatoren e Adem Jashari. Kaq pata.

**Kryesuesi:** Replikë Halim Halimi.

**Halim Halimi:** Çka i paska gjetur sot këta të PDK-së shumë po fërkohen për meje. Është çështja, ne e kemi në rend të ditës çështjen e obeliskut, jemi duke fol, për sheshin "Adem Jashari". Na si LDK e kemi dhënë vendimin dhe kemi vendos 2005-2006, është e vërtetë, edhe në mbledhjen e kaluar kemi thënë që sheshi "Adem Jashari" është aty dhe le të bëhet busti i Adem Jasharit aty, na punën e kemi kryer. Unë nuk e di pse tash po e përmend kur kemi të bëjmë me obeliskun për ushtarët e rënë të KFOR-it edhe të NATO-së të cilët paskan vdekur aksidentalisht. Po o burrë na e dimë, na nëse doni i themi aksidentalisht, a qysh të doni, e dimë rolin e NATO-së dhe të KFOR-it në Kosovë, bile as që duhet me menduar për këtë çështje, e mos të bëhemi këtu patriotë pa qenë hiq.

Ju faleminderit.

**Kryesuesi:** Migjen Shala kundër replikë.

**Migjen Shala:** Këtu dihet kush është patriot dhe kush ka kontribuar për vendin, nën një. Nëse keni dashur ju keni mundur ta rregulloni sheshin, tash sheshin është duke e rregulluar kjo qeverisje. E mirë e keqe, i mirë e i keq Shpend Ahmeti e ka marrë vendim me asi, ti nuk e ke rregulluar këtë shesh, ti ke qenë kundër sheshit të "Adem Jasharit". E keni miratuar me vota, mirëpo sheshi nuk është rregulluar, nuk është rregulluar shtatorja, o zotëri me 52 anëtarë të familjes ka vdekur ai, emri i Adem Jasharit është përmend në Këshill të Sigurimit, krejt bota e dinë. I vetmi qyteti i Prishtinës se që ke qeverisë ti qe sa vite këtu në komunë me shokët e tu që nuk e ke rregulluar, qysh duhet me qenë kundër kur nuk e rregulloj unë sheshin, se rregulloj unë shtatoren, ne nuk kem kurrgjë kundër obeliskut të ushtarëve të KFOR-it. Na jemi për, mirëpo kjo po mbetet anash, jo e lëmë në një seancë tjetër, jo e lëmë, jo e lëmë kështu, jo e lëmë ashtu, kjo është e tepërt po të tregoj drejt, kaq pata.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë.

Besnik Mujeci.

**Besnik Mujeci:** Përshëndetje të gjithëve.

Edhe unë desha të ndërlidhem me këtë çështjen e obeliskut, pasi që ka qe 19 vite pas lufte e kemi lënë anash familjen Jashari, e cila është sakrifikuar me të gjithë anëtarët e familjes së tyre, dhe këtu me procedura nguti ta vendosim një obelisk KFOR-it d.m.th. është si një

hipokrizi nga ana jonë, pasi që po i harrojmë të tanët dhe po i qesim të huajt përpara. Duke e pas parasysh faktin se edhe sheshi është i ngarkuar jashtëzakonisht shumë me përmendore dhe me obeliskë, mendoj që nuk është vendi adekuat që ti caktohet midis sheshit të Prishtinës, një obelisk KFOR-it.

Faleminderit.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë.

Egzon Azemi.

**Egzon Azemi:** Faleminderit kryesues.

Parimisht normal se jemi pro këtij obelisku, mirëpo fatkeqësisht duhet gjithsesi me përmend se edhe ekzekutivi i tanishëm, se më për LDK-në nuk po flasim se e dimë të gjithë historikisht çka ka menduar për UÇK-në, mirëpo edhe kjo qeverisje e tanishme fatkeqësisht është duke e degraduar çdo vlerë kombëtare.

**Kryesuesi:** Ju lutem rreth pikës së rendit të ditës.

**Egzon Azemi:** Te Shtatorja e "Zahir Pajazitit" ende nuk është vendos një flamur kombëtar, ende edhe pse ka pas premtime nga zyrtarë këtu, nga drejtor komunal, ende nuk është vendos të paktën një flamur, e kjo është turp. Varrezat në Viti të Marecit, varrezat e dëshmorëve, edhe pse ka pas premtim që ka me filluar, që sapo të ndreqet koha kanë me filluar punimet, ende nuk kanë nis punimet. Varrezat e dëshmorëve në Velani janë pamja më e qartë se çka ka ndodhur me dëshmorët e UÇK-së dhe çka ka ndodhë me figurat tjera. Aty është i varrosur Ibrahim Rugova dhe të gjithë mundemi me pa çfarë varri luksoz sot ka, dhe fatkeqësisht nëse e shikon gjendjen e varrezave të dëshmorëve, është për me të ardhur keq. Kështu që për këto çështje ekzekutivi nuk duhet ti mbyll sytë dhe duhet sa më shpejtë të ndërmer hapa konkret.

Faleminderit.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë.

Veç diçka, ju lutem veç diçka, ideja është që ti përmbahemi pikës së rendit të ditës. Obelisku është në pyetje, normalisht që janë temë e rëndësishme edhe çështjet që u ngritën këtu, mirëpo unë mendoj që ato mund të trajtohen në një seancë tjetër, ose të jashtëzakonshme ose si pikë e rregullt, tash të fokusohemi te obelisku.

Faleminderit shumë

Nënkryetari e deshi fjalën.

**Nënkryetari Selim Pacolli:** Përshëndetje të gjithëve.

Migjen edhe Egzon a po? Na jemi të vetëdijshëm për sheshin "Adem Jashari", për obeliskun e NATO-së, për varrezat e dëshmorëve edhe për varrin e Ibrahim Rugovës, secili e ka vlerën e vetë, në kohën e vetë, në kohën e duhur. Si ekzekutiv i komunës sigurisht që kemi programe që si do të ndërtohen edhe varrezat, mirëpo sa i përket një sheshi të Adem Jasharit, unë e kam cek edhe në mbledhjen e kaluar kur ishim këtu bashkë, që unë besoj që në një vend ku e kemi ne një përmendore të kohës së kaluar, nuk do të duhej ta përcaktoj se çfarë përfaqëson ajo përmendore aty dhe ajo e Adem Jasharit. Nuk do të ishte në rregull të jenë në një vend ato, sepse janë dy kohëra historike të ndryshme. Unë nuk do të doja të kthehem e të diskutoj këtu për vlerën e atëhershme, ose për vlerën të cilën ne e kemi përjetuar bashkë, unë konsideroj që për sheshin "Adem Jashari" duhet të kemi shumë kujdes të gjithë se ku do ta vendosim. Ai nuk është një shesh ose një shtatore e "Adem Jasharit" që sot ta vendosim diku e nesër dikush qohet e thotë jo nuk e paska vendin e duhur këtu se do ta zhvendosim diku tjetër, se ne nuk

po mundemi ta zhvendosim sot trekëndëshin prej këtu, se nuk është aq e lehtë për zhvendosjen e monumenteve, çfarëdo qofshin ato, dhe si e tillë unë konsideroj që në mbledhjet e ardhshme ne duhet bashkë edhe ekzekutivi të kemi një propozim para asamblesë, se ku ne do të mendojmë së bashku ta vendosim sheshin "Adem Jashari". Ajo të cilën e tha edhe Egzoni po më duket pak më herët, sheshi është i stërrngarkuar me shtatore, e kemi thujtë të ngjashëm me Shkupin, e kemi bërë njëfarë lloj fantazme, kur futesh ti në Shkup, Shkupi i ngjanë një fantazme varrezash të cilët janë anë e mbanë, në të djathtë e në të majtë, para dhe prapa, shtatore të tilla ekzistente apo inekzistente, apo janë të imagjinuara, unë besoj që Prishtina nuk meriton të jetë një qytet i tillë, sigurisht që jo. Vlerën e sheshit "Adem Jashari", besoj që secili, edhe fëmijët të cilët fare nuk kanë qenë në atë kohë të lindur, ose edhe ata që sot lindin, së paku do të marrin ndjenja nga prindërit e vetë thjeshtë për një shtatore të tij se ku ne duhet ta vendosim atë. Si të tillë ne kemi pritur që 18 vjet, kemi pritur që 14 vite apo sa prej kur është vendos për një shesh të "Adem Jasharit" dhe është emërtuar pikërisht prej këtij Kuvendi këtu dhe pse nuk është ekzekutuar? Pse nuk është ndërtuar deri sot, unë nuk e di? Ndoshta është dashur që do ishte pikërisht një shtatore, ose një shesh i parë në Prishtinë që do të duhej të ishte me atë emër, me atë mbiemër, të heroit tonë kombëtar. Ne nuk mund ta zbehim në asnjë mënyrë as luftën, as angazhimin, as rënien e 52 anëtarëve të familjes Jashari, po ne nuk mund ta zhbëjmë as një luftë paqësore e cila ishte bërë në krye me Ibrahim Rugovën, ose me anëtarët e atij subjekti politik si lëvizje. Dhe si të tillë ne kot, dëgjo ne mund të themi diçka tjetër, por historia nuk fshihet, besoni që nuk fshihet, se nuk fshihet. Unë propozoj, edhe kryesuesi, që ne ta hedhim në votim çështjen e këtij obelisku, i cili do të ngritët, se ne duhet të jemi mirënjohës edhe ndaj NATO-së, edhe ushtarëve të tyre të cilët kanë rënë në Kosovë, se ata ne nuk i kemi thirr me ftesa këtu sigurisht, mirëpo ata kanë ardhur për një qëllim human dhe kanë intervenuar që edhe ne thjesht që mos të ishim shndërruar ndoshta në një Bosnje të mundshme. Nuk po flas në aspektin politik, së paku po flas në aspektin human i cili ka ndodhur atje, dhe ne do të duhej të jemi mirënjohës NATO-së edhe KFOR-it sot i cili është, se edhe ata kanë investuar në vlerat shoqërore, por edhe paqësore të Kosovës. Andaj besoj që çdo fjalim i tepërt këtu, nuk do të kishte ndoshta edhe arsye sot, e hedhim në votim dhe ecim më tutje.

Faleminderit.

**Kryesuesi:** Faleminderit nënkryetar.

Atëherë puna e diskutimit është e drejtë e secilit, vetëm nëse tërhiqeni ne mund të shkojmë më tutje.

Valbona Ajeti.

**Valbona Ajeti:** Faleminderit i nderuar kryesues;

I nderuar nënkryetar;

Ju drejtorë, dhe

Ju kolegë këshilltarë.

Unë në emër të GP të AAK-së them se jemi përkrah kësaj pllake përkujtimore të vendosjes aty në shesh, dhe ne do ta votojmë pro këtë pllakë, kështu që propozimi jonë është që sa më shpejt të hidhet në votim.

Ju faleminderit.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë.

Nol Nushi.

**Nol Nushi:** Po, po përsëritet tema e kaluar lidhur me sheshin "Adem Jashari". Unë mendoj që duke e përmend shpesh pak jemi duke e keqpërdorur edhe emrin e Adem Jasharit, se nuk besoj që na bënë mirë veç me e përmendur atë emër, edhe kështu me e përdor për sende tjera. Na mundemi me i vendos edhe 100 mijë flamuj edhe krejt me i rregulluar, por kjo nuk tregon fort bash për respektin për atë, për dëshmorët, nëse punën nuk e kryejmë këtu si duhet si komunë e si kështu. Prapë po na prishen, po na keqinterpretohen kompetencat si Kuvend. Kuvendi nuk ka të drejtë me maru obeliskë, as përmendore, as kurrgjë, ky vendim që na ka ardhur sot nuk është vendim për me maru obeliskun, praktikisht është vendim me ia caktuar parcelën, lokacionin, na këtë kompetencë e kemi. Na nuk mundemi me caktuar këtu me thënë duam midis të rrethit me maru një obelisk prej 12 metrave p.sh. të cilës do figurë, nuk e kemi atë kompetencë, mundemi me propozuar, nuk vendoset këtu kurrgjë, i kemi kompetencat goxha të limituara për këtë punë, e a e vendosin a jo, çdo qeverisje që e udhëheqë Prishtinën e merr përgjegjësinë edhe përballet pastaj me votuesin, me veprimet ose mosveprimet e veta. Unë mendoj që nuk ka asnjë problem nëse ky propozim që ka ardhur nga KFOR-i votohet, unë veç një pyetje e kisha nëse mundet me e sqaruar dikush lidhur me pikën, d.m.th. këtu po shkruan që në përkujtim të pjesëtarëve të KFOR-it të cilët dhanë sakrificën e fundit, derisa shërbenin në mbështetje të Kosovës. A është fjala për ushtarë që janë vlarë, që kanë vdekur aksidentalisht, që kanë vdekur për shkaqe natyrore gjatë shërbimit të tyre në Kosovë? Sepse mendoj që sakrificat e fundit është relative, për dikën sakrificë e fundit u kanë me ardhur prej Anglisë me luftuar këtu, për dikën u kanë me vdekur këtu, pra, nëse këqyrim kështu. Veç po më intereson me e saktësuar, sepse mendoj që nëse i fusim krejt me një kallëp kushtimisht me thënë, dikujt i hymë në hak këtu, se nuk është njësoj si ai që është vra këtu në konfrontim me forcat serbe, si ai që ka vdekur për shkaqe natyrore. Falënderues të gjithëve, por sakrificat nuk është e njëjtë, veç këtë sqarim e desha.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë.

Drejtor a e donë fjalën?

**Genc Bashota:** Unë më sa e di se nuk i di edhe unë detajet, e kanë dizajnuar, prapë po e them KFOR-i e ka dizajnuar, më sa unë jam i informuar është fjala për të gjithë ushtarët që kanë vdekur gjatë gjithë misionit prej vitit 1999 deri sot. Format si kanë ndodhur ato nuk e di, po ata duan me i respektuar të gjithë ata që kanë qenë në mision në Kosovë, dhe prapë e kisha lënë si një çështje që e kanë vendos se kjo temë kish shkuar deri në Bruksel goxha në nivele të larta, do të thotë nuk kisha hyrë në detaje qysh e tek. Ne mendoj që duhet të jemi, mos të mbaj fjalim politik se nuk më takon, por duhet të jemi falënderues të gjithë atyre që kanë ardhur dhe kanë kontribuar për këtë çlirim që e kemi sot.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor.

Regjia diskutuesit.

Shefki Gashi.

**Shefki Gashi:** Faleminderit.

Unë e pash për obligim pasi jam këtu prej më të vjetërve dhe prej vitit 1999, se e pash që u bënë nja 2-3 gabime këtu, se nuk janë emëruar sheshet "Adem Jashari", "Ibrahim Rugova" nga LDK-ja. Sheshi "Adem Jashari" u emërua në kohën e Qeverisë së Përkohshme në vitin 1999, edhe është caktuar këtu. Kurse sheshi "Ibrahim Rugova" është emëruar në vitin 2006. Prandaj këta nuk kanë kurrfarë lidhje njëri me tjetrin në bazë të vendimit kur është marr, si vende që janë emëruar si kompetencë e Kuvendit Komunal të Prishtinës. Pse LDK-ja edhe

atëherë edhe më vonë nuk e ka rregulluar, LDK-ja si subjekt i djathtë politik jo vetëm simbolet, objektet, përmendoret, ato që kanë qenë socialiste edhe veprimet e tyre dhe ligjet që i kanë pas ata nuk i përfillë. Prandaj nuk ka qenë normale që një trekëndësh që është i vendosur këtu, nuk e di se nuk kam moshatar këtu, unë e mbaj në mend është ndërtuar këtu në vitin 1963, edhe atëherë kanë thënë se kjo është: Hej slloveni, serbi, hrvati, slloveni edhe të tjerët jemi na, romët, ashkali nuk ka pas atëherë as egjiptas, turqit, jemi këta të zinj të poshtë. Prandaj na me e vendos Adem Jasharin në mesin e atyre aty nuk kemi pranuar. Është bërë plani, është bërë projekti, janë ndarë mjetet, për me e ndërtuar sheshin, me e ndërtuar me garazhe nëntokësore, me u ngrit niveli dhe me u vendos sheshi i Adem Jasharit. Nuk kanë lejuar, problemi ka qenë me filluar edhe pasi të gërmohet u rrezikua po e heqim për momentin dhe me vendos pastaj, po mos me e vendos kurrë më aty, edhe ajo nuk e ka vendin aty, edhe është gabim shumë i madh nëse nesër vendoset edhe Adem Jashari me gjithë respektin edhe cilido qoftë luftëtar i Kosovës, bashkë me ato pjesë që janë aty. E dyta këta LDK – ja në luftë, dëgjoni, jeni të rinj, jeni fëmijë, jeni të prindërve, disa të prindërve ... (Fjala nuk kuptohet), disa jo, disa çka po di unë, nuk e di të kujt jeni, po pa LDK as nuk ka pas Pavarësi të Kosovës, as nuk ka pas Qeveri të Kosovës atëherë, as nuk ka pas Alternativë pa LDK-në, e dinë Jonuzi Alternativa kush u kanë, as nuk ka pas luftë pa LDK-në. Mirë e dinë Fadili se qysh janë kanë kryetarët e aktiveve, janë bërë komandant të njësiteve, kurse strukturat e larta kemi qenë pak më, a po kupton a jo. E pse na nuk jemi shantazhuar e nuk jemi marr me veprime të ndryshme, ajo nuk është etike, nuk është veti e LDK-së, as nuk ka me qenë kurrë, urdhëroni shkarravitni Kosovën, merreni, korruptojeni, vidheni, bëni të gjitha, ndani ato krejt, a po kuptoni apo jo, gjuajeni me gur, kalleni, bëni të gjitha. LDK-ja nuk ju bashkëngjitet kurrë, LDK-ja është parti e kombit edhe zotit, e këtë duhet që ta mbani në mend. Në LDK keni hise të gjithë ju këtu, bile dikush më shumë se unë, se baballarët e juaj para meje janë anëtarësuar në LDK, unë pak më vonë, e dinë këta bashkë partiakët e mi, kështu që hise kemi të gjithë e mosni se tash është ringjallur po më duket ndjenja për LDK-në edhe në popull është një furtunë, por me e ndalur nuk mundeni, nuk ka pas mujt as Serbia me e ndalur atëherë, ngadalë po shumë sigurt.

Ju faleminderit.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë.

Leutrim Retkoceri.

**Leutrim Retkoceri:** Unë po e shoh të nevojshme me e bërë një sqarim se tema që u ngrit prej neve nuk ishte kjo pse po bënë, ajo nuk bënë tash mos me e qit, ideja është që veç është moment i mirë me bërë një krahasim, se qysh po i trajtojmë temat. Kur na vjen një kërkesë prej jashtë, çfarëdo qoftë atje, dimë me kanë shumë servil, me i pranuar pa hezitim sikur kryesuesi i LDK-së që e përmendi, me e hedhë shumë shpejtë në votim, ndërsa temat tona ne nuk i trajtojmë. Ky ishte moment i mirë që e ngritëm si anëtarë të PDK-së, me na shërbyer në të ardhmen se qysh me i trajtuar temat, të paktën me i trajtuar njëjtë, është përgjegjësi e jona si përfaqësues këtu. Tjetra, para se me kaluar kjo temë në komedi, Halimi e përmendi tha pse po më kapën PDK-ja nuk po e di, z. Halim veç një përgjigje të shkurtë po ta japë: Jeni kryesues i LDK-së edhe për juve personalisht nuk mundem me tu kap asnjëherë sepse nuk kam kurrëgjë, mirëpo je kryesues i një subjekti i cili ka përgjegjësi për disa vendime në këtë vend, në këtë kryeqytet. Gjithashtu ju thash edhe më herët, pse jeni lodhur e pse jeni dorëzuar, elektorati ju ka qar në shtëpi, dhe për atë mos të ju vjen keq hiq se është realitet, ndërsa për këtë temë

kryesues pa hupë kohë para se me kaluar në komedi, dhe një sqarim e dhashë që ke rast i mirë veç me ju treguar se është përgjegjësi e jona me i trajtuar temat njëjtë, barazi, për njerëz që kanë sakrifikuar për këtë vend, qoftë duke i respektuar edhe miqtë tanë siç janë NATO dhe KFOR-i.

Faleminderit.

**Kryesuesi:** Faleminderit.

Replikë Halim Halimi.

**Halim Halimi:** Unë jam i LDK-së dhe LDK-ja është parti ...(Fjala nuk kuptohet), ata të cilët duan në këtë Kuvend me bërë shou, flasin kështu. Ata të cilët duan me punuar diçka me u marr me çështje bazike, flasin qysh flasin na. Kurrkush as prej LDK-së dhe askënd nuk e dëgjoj këtu që është kundër Adem Jasharit, të gjithë jemi që le të punojmë, po le ta duan qysh duhet dhe le ta respektojnë këta vetë, mos të përfitojnë në emër të Adem Jasharit lloj-lloj benificionesh, e këtu tash me mu shit patriotë se ne po bëjmë këtë, po bëjmë këtë, po urdhëroni, pra bëjeni.

**Kryesuesi:** Faleminderit.

Me radhë është Eman Rrahmani

Secili anëtarë ka të drejtë të fjalës njëherë,

Migjen ke fol njëherë në fillim për këtë temë.

Urdhëro Eman.

**Eman Rrahmani:** Natyrisht jemi pro kësaj dhe do ta përkrahim këtë propozim. Unë kisha pas një propozim me ia liruar dikush vendin Nolit me dal atje me na këshilluar çka është ligjore, çka nuk është ligjore dhe çka duhet me bërë. Dhe desha me i treguar që për me dal në televizion duhet me e pas dost Batonin, e jo me fol këtu, se këtu nuk të qet kurrkush.

**Kryesuesi:** Adelina Fazliji.

**Adelina Fazliji:** Propozoj që këtë pikë të rendit të ditës me e qitë në votim, edhe PDK-ja e LDK-ja këto probleme që po duan me i diskutuar, munden me dal jashtë me diskutuar, sepse nuk po besoj se ia vlen me i dëgjuat debatet e tyre, sepse mua për veti personalisht nuk po më interesojnë çështjet e PDK-së dhe LDK-së, kisha thënë me e vazhduar më tutje.

**Kryesuesi:** Faleminderit.

Fadil Gashi.

**Fadil Gashi:** Kryesues qite në votim se me i lënë këta gjithë ditën këta secili më patriotë se tjetri del, edhe e dimë kush jemi tek jemi, secili e dimë çka kemi bërë se krejt e duam Adem Jasharin, nuk jemi që nuk e duam, po qite në votim e mos të humbim kohë.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë.

Atëherë regjia ju lutem gati për votim.

Votojmë tash.

Regjia gati ju lutem.

Votojmë tash.

**Atëherë me 40 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, miratohet Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e Obeliskut në përkujtim të pjesëtarëve të KFOR-it dhe të NATO-së.**

Faleminderit shumë.



## Pika e tretë

### Miratimi i Raportit financiar të tremujorit të parë (TM1), të vitit 2018.

**Kryesuesi:** Do të shkojmë me radhë me GP.

Ju lutem fillimisht të paraqiten përfaqësuesit e GP.

Halim Halimi.

**Halim Halimi:** Faleminderit kryesues.

Ne si GP e kemi analizuar Raportin tremujor dhe e kisha ftuar në emër të GP të LDK-së që të na përfaqësoj Agim Gashi, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

**Kryesuesi:** Faleminderit.

Agim Gashi në emër të GP të LDK-së.

**Agim Gashi:** Faleminderit kryesues.

Pra, ne kemi në duar Raportin tremujor financiar buxhetor të Komunës së Prishtinës, për periudhën janar-mars 2018, i cili është dokument kryesor për të pasqyruar punën e qeverisë komunale në këtë periudhë, që është periudhë shumë e rëndësishme e vitit buxhetor, sepse ashtu si fillon kjo periudhë, ashtu edhe vazhdon puna njëvjeçare. Megjithëse këtu në raport mungojnë disa informacione të cilat do të mund të na mundësonin ta vlerësojmë më mirë se në çfarë trendi dhe në çfarë shkalle të zhvillimit të punëve është qeveria komunale. P.sh. mungon një informacion i Planit të prokurimit, që do të mund të determinonte se cila është dinamika e zhvillimit të punëve të planifikuara, dhe ne tani bazohemi vetëm në pasqyrat financiare të prezantuara këtu, por nuk e dimë se si është e dinamizuar puna më tutje, sepse mungojnë të dhënat nga Zyra e prokurimit. Megjithatë, Raporti TM1 për vitin 2018, prezanton të hyra më të ulëta dhe një performancë të shpenzimeve të caktuara, që do të thotë se ky është një trend negativ i zhvillimit për tremujorin e parë. Sipas Raportit të hyrat për këtë tremujor janë 11.99%, më të ulëta në krahasim me TM1 e vitit 2017, gjegjësisht janë inkasuar diku 5.424.614 euro, ose 18% e planifikimit 2018, që është një trend mjaftë i ulët në këtë fushë, ose një sasi mjaftë e ulët e mjeteve, në vend se të shënonte një rritje prej 10-11-12, në krahasim ka shënuar rënie. Ky është realizim mjaftë i ulët kur ta kemi parasysh që sivjet ka kushte më të mira për inkasimin e mjeteve të, të hyrave vetjake, duke marrë parasysh se qeveria komunale ka marr një barrë ligjore për inkasimin e mjeteve nga mbeturinat, që më herët i ka inkasuar Kompania "Pastrimi". Sa për informacion po ju them se në tremujorin e parë të vitit të kaluar nga Kompania "Pastrimi" janë inkasuar diku 600 e diçka mijë euro, ndërsa këtu në Raport shihet se qeveria komunale ka inkasuar vetëm 133.000 euro që është një rënie prej 495.966 euro më pak. Kur ta kryej unë, ti merre fjalën dhe thuaj të tuat, po. Rënie në këtë fushë vërehen edhe te lejet e ndërtimit, te shfrytëzimi i sipërfaqeve publike, vërehet edhe në fushën e arsimit, parkingjeve etj., por ka ngritje edhe në disa sfera tjera, por sido që të jetë Raporti është i tillë se në tërësi të hyrat janë për 11.99%, më të ulëta. I përmenda këto fusha ku ka rënie për shkak se këto janë fusha ku gjenerimi i të hyrave është mjaftë stabil, sidomos inkasimi i mjeteve nga shfrytëzimi i hapësirave publike, ku lokalet kanë punuar gjatë tërë dimrit dhe aty nuk ka pas ndërprerje, ndërtimet nuk janë ndërprerë gjatë tërë sezonit dimëror, sepse kushtet atmosferike kanë qenë mjaftë të mira, pastaj në arsim nuk ka ndryshuar numri i fëmijëve të regjistruar në institucionet parashkollore dhe nuk e di pse ka

rënie. Me një fjalë këtu është dashur që në Raport të jepen disa fjali sqaruese për të kuptuar na më drejtë se cilët kanë qenë faktorët të cilët kanë ndikuar në uljen e të hyrave në këtë tremujor. Ndoshta në tremujorët e ardhshëm pas...(Fjala nuk kuptohet), do të mund të përmirësohet kjo gjendje, por për momentin kjo është gjendja faktike. Shpenzimet kanë shënuar sipas Raportit një rritje, po planifikimi fillestar i buxhetit bazuar në qarkoren buxhetore ka qenë 71.222.581. Pas rritjes së pagave buxheti është bërë 72.273.904, por në raport nuk përfshihet fare bartja e mjeteve prej vitit 2017, ku përfshin shumën prej 14.850.904 euro. Unë konsideroj, përkatësisht GP i LDK-së konsideron se shmangia e kësaj vlere të mjeteve që ishin bartje nga viti 2017, nuk paraqet pasqyrë reale të prezantimit të të dhënave të pasqyrave financiare, sepse ajo është pjesë integrale e buxhetit të vitit 2018, dhe nuk mund ti ikësh asaj, sepse ne e dimë që ato mjete kanë qenë të kontraktuara. Ato punë që janë kryer, nëse është kryer ndonjë punë në aspektin, sidomos në investime kapitale në këtë tremujor, është kryer pikërisht nga ato mjete, ndërsa në pasqyra këto nuk figurojnë, ose ka qenë dashur të ndahen dhe të jepet një raport pak më i detajizuar pikërisht për sasinë e mjeteve të bartura. Vërehet një rritje tek shpenzimet dhe mallrat, pagat dhe mëditjet, që këto janë ta them rritje të natyrshme për shkak se në një komunë për çdo vit do të ketë rritje, sidomos në shpenzime dhe mallra, në mirëmbajtje, por mund të ketë edhe në paga dhe mëditje. Mirëpo ulja e të hyrave dhe rritja e shpenzimeve kur nuk janë harmonike, nuk janë proporcionale, krijon një disbalanc ekonomik dhe kjo nuk është e natyrshme të ketë të hyra më pak 12%, dhe të ketë rritje ta zëmë tek mallrat dhe shërbimet 38%, ose gati 4% në total, kjo është plotësisht një disbalanc dhe ...(jashtë mikrofonit). Në raport nuk është dhënë asnjë shpjegim sqarues për këtë dështim, që të sqarohet ose specifikisht të tregohet se ka rënie në këtë fushë, apo në atë fushë, ose pse ka rënie në fusha të caktuara, ose pse nuk ka shpenzime tek subvencionet dhe transferet. Ne e dimë se kryesisht dy fushat më të rëndësishme janë investimet kapitale dhe subvencionet dhe transferet, nëse e krahasojmë edhe pse në vitin 2017, shpenzimet për subvencione dhe transfere kanë qenë shumë të ulëta. Në këtë vit ka rënie edhe më tutje, ka rënie për 32.64%, që është një rënie shumë e madhe, që do të thotë vetëm 113.000 euro,

**Kryesuesi:** Më falni vetëm një sekondë se ka mbaruar koha.

Regjia të lutem vazhdoje,

Edhe sa kohë të duhet përafërsisht pasi që je në emër të GP?

**Agim Gashi:** Edhe një minutë dhe po e përfundoj.

**Kryesuesi:** Vazhdo në emër të GP edhe dy minuta.

**Agim Gashi:** Ndërsa në investime kapitale ka vetëm 2.61% realizim të planit ose 685.000 euro shpenzim nga sa janë atje gati 30.000.000 euro, bashkë me mjetet e bartura. Ne propozojmë që qeveria të merr masa në këtë drejtim, se pse përformanca është shumë e ulët, dhe të merr masa që të përmirësohet kjo gjendje për arsye se do ta humbë hapin dhe faktikisht e ka humbë hapin e realizimit të planit 2018, dhe kjo do të shkoj në dëm të interesave të qytetarëve të Komunës së Prishtinës, kështu siç është ky raport me këtë punë, LDK-ja nuk do ta përkrahë.

Ju faleminderit.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë.

Tash po shkojmë me radhë..

GP ose diskutojnë, ose shprehin qëndrimin e tyre për ose kundër.

Grupi i Deputetëve të Pavarur Vala Peshku.

Regjia të lutem Leonora Shabani-Bajraktari.

E presim pak regjinë.

Vazhdo Leonora.

**Leonora Shabani-Bajraktari:** Ndoshta dëgjohem.

Unë ia kaloj fjalën asamblistit të lëvizjes Eman Rrahmanit, kështu që propozimet e LVV për Raportin financiar i deklaroi Eman Rrahmani.

Ju faleminderit.

**Kryesuesi:** OK, në emër të GP të LVV-së, Eman Rrahmani.

**Eman Rrahmani:** Faleminderit kryesues.

Faleminderit Leonorë.

Raporti i tremujorit të parë në krahasim me vitin 2017, me e thënë të drejtën tregon një jo efikasitet të qeverisjes, për shkak që ashtu siç u deklarova edhe më herët kemi rritje të shpenzimeve dhe kemi të hyra shumë më pak, se sa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Mendoj që qeverisja seriozisht duhet me i marrë parasysh këto statistika të cilat kanë dal këtu, dhe të merret me to, për shkak që në qoftë se vazhdohet me këtë trend deri në fund të vitit, atëherë besoj që do të kemi një ngecje në qeverisje, dhe këtë do ta pësojnë qytetarët e Prishtinës. Nuk po hy shumë gjatë me i elaboruar statitakisht ku ka ngritje dhe ku ka zbritje për shkak që këta numra i ceku më herët edhe parafolësi, kështu që ajo çka dua me thënë është që p.sh. në Drejtorinë e Investimeve Kapitale, kemi realizim vetëm 3.46% shpenzime kapitale, gjë që tregon që nuk po e di arsyen, ndoshta mundet edhe drejtori me e shpjeguar meqenëse është këtu pak a shumë, por po mendoj që është një performancë shumë, shumë e ulët për tremujorin e kaluar. Pothuajse njëjtë shkojnë gati të gjitha drejtoritë, e vetmja ku kemi një ngritje d.m.th. është te mallrat dhe shërbimet, që është shpenzime 38.54%. Kjo me të vërtetë është shqetësuese, qysh ka mundësi shpenzimet prej vitit të kaluar në këtë vit me u rrit për 38.54%, për mua është e pakuptueshme, dhe kisha dashur që në raportet tjera financiare me u detajizuar pak më shumë, po mendoj që ka një progres prej raportit të kaluar, mirëpo besoj që duhet me shkuar edhe pak më shumë në detaje për me e pasur edhe ne në të qartë, me e ditur se ku saktësisht ka ngecje të projekteve edhe me e pas një vlerësim më të mirë për gjendjen. Shqetësuese mbesin prapë këto detyrimet, lëndët nëpër gjykata që i kemi, janë jashtëzakonisht të gjata dhe me vlera shumë të mëdha. Unë personalisht jam angazhuar, kam bërë shumë kërkesa për investime të ndryshme gjë që nuk mundem me e kuptuar, pse nuk investohet, kur janë të gjitha ato mjete financiare të lira edhe që nuk harxhohen asnjë, janë të pakuptueshme. Si raport total, është një raport më i mirë, po mendoj në statistika, në paraqitje dhe në shpjegime se sa raporti i kaluar, por qysh e thash edhe besoj që duhet edhe pak progres me pas sidomos në detajimin e projekteve aty ku ka mundësi. Për me u informuar pak më shumë për shkak që me ardhur deri te qëndrimet dhe me e ditur saktësisht se ku është problemi, për shkak se p.sh. te mallrat e shërbimet nuk mundesh me e ditur ti në cilën kategori ka rritje kaq të madhe të shpenzimeve, tjetër nuk kam.

**Kryesuesi:** Faleminderit.

Vala Peshku Grupi i Pavarur.

**Vala Peshku:** Po bënë.

Kështu, së pari duheni me e kuptuar një gjë, Raporti financiar është ndodhi, është numër, nuk ka këtu çka votohet apo mundet me u diskutuar pse diçka ka ndodhur, apo nuk ka ndodhur, por nuk mundet me u ndryshuar numrat, pse neve nuk po na pëlqejnë, veç pak të lutem, OK. Tash çështje diskutimi mundet me qenë me u kërkuar prej secilës drejtori pse diçka është bërë, apo nuk është bërë, por nuk duhet me e kuptuar këtë Raport financiar si diçka që ne mundemi me e ndryshuar, sepse nuk ndryshojnë numrat, kjo është ndodhia deri sot. Mundemi me bërë presion dhe me kërkuar përgjegjësi më të madhe prej drejtorive që tutje ekzekutimin me e pas më të mirë. Prandaj, e kam fjalën te zotri i LDK-së që tha nuk e miratojmë, nuk ka këtu çka mos me u miratuar, kjo ka ndodhë dhe si e tillë mbetet, tutje vazhdohet me punët tjera. Në parim jemi OK. Më duhet me e përgëzuar drejtoreshën që me të vërtetë ka bërë mund për me e ndryshuar, se herën e kaluar ka qenë në formë shumë çfarë e dimë. Besoj që në ndërkohë kemi me pas edhe propozime tjera se si mundet kjo më mirë me u prezantuar, përndryshe secili prej nesh nëse ka pyetje për cilëndo drejtori për performancën e tyre, secili do të bëjë pyetje vetë.  
Faleminderit.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë.  
Replikë, jo replikë është, ju referuar.  
Replikë.

**Agim Gashi:** Përfaqësuesi i LDK-së, nuk...(Jashtë mikrofonit), dhe dalloni kuptimet, qoftë edhe nuancore. Në këtë rast është fjala për përkrahjen e punës dhe mospërkrahjen e punës. Raporti fletë për punën, numrat shndërrohen në kuptimësi teorike, dhe rezultatet e kësaj ne nuk i përkrahim se dëshirojmë me qenë më të mira, natyrisht që nuk janë më të mira.  
Faleminderit.

**Kryesuesi:** Faleminderit.  
Në emër të GP i PDK-së Leutrim Retkoceri

**Leutrim Retkoceri:** Faleminderit kryesues.  
Përshëndetje kolegë.

Ne e kemi shqyrtuar Raportin financiar për tremujorin e vitit 2018. Nga ky raport vlen të ceket dhe të përgëzohen përgatitësit e raportit, se është një raport i përgatitur më mirë, se sa ai paraprak që e kemi marr për tre muajt e fundit të vitit 2017. Ndërsa në brendësi të këtij raporti kemi vërejtur se kemi shënuar, komuna ka shënuar të hyra më të ulëta se sa në tremujorin e vitit paraprak, ky është një shqetësim i joni si GP i PDK-së, vlen të ceket që në mesin e këtyre të hyrave të ulëta janë edhe në lejet e ndërimit, apo edhe në inkasimet tjera, që është për shqetësim. Shpenzimet në paga dhe mëditje është një shqetësim tjetër që na e kemi ngritur në vazhdimësi, sepse ka pas punësime në qeverisjen e kaluar të cilat po shihet që edhe tash po mbulohen me buxhetin e Komunës së Prishtinës. Ndërsa për tatimin në pronë dhe vendimet tjera, shohim se disa vendime të qeverisjes së kaluar, nuk kanë rezultuar në të hyra, nuk janë përkthyer në të hyra për buxhetin e Komunës së Prishtinës. Ne si GP i PDK-së e inkurajojmë drejtorinë dhe komunën që të bëjë përpjekje që të inkasoj më shumë të hyra, dhe shpenzimet ti reduktoj. Në parim do të ketë përkrahjen tonë në këto pika, mirëpo do të jemi në

vazhdimësi kërkues që të kemi një transparencë më të madhe, të hyra më të mëdha dhe shpenzime sa më të ulëta, sidomos në mallra dhe shpenzime, për shkak se është mundësia që të ulen ato, e kemi ngritur disa herë këtë shqetësim.  
Faleminderit.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë.

Në emër të AAK-së, regjia.

Valbona Ajeti, se nuk pash.

**Valbona Ajeti:** Faleminderit i nderuari kryesues,

Edhe grupi ynë parlamentar e përkrah në parim Raportin financiar për tremujorin e parë, me shpresën se herën tjetër do të vjen një raport edhe më i mirë.

Faleminderit.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë.

Në emër të AKR-së, AA-së

Vesel Makolli.

**Vesel Makolli:** Në emër të grupit tonë Sami Boroci do ta japë komentimin.

**Kryesuesi:** Në rregull, Sami Boroci në emër të grupit.

**Sami Boroci:** Faleminderit kryesues.

Faleminderit Vesel.

Atëherë fillimisht po dua me e falënderuar drejtorinë, ose drejtoreshën për një raport i cili për neve është shumë më i qartë se sa ai i herës së kaluar. Ndonëse në përmbajtje normalisht kemi komente, mirëpo te aspekti i paraqitjes të të dhënave në raport, është shumë më i detajizuar se sa herën e kaluar, normalisht që ka vend për përmirësim, por po dua me e falënderuar drejtoreshën që i ka marr parasysh, po mendoj rekomandimet tona. Mendoj që ky raport i pasqyron edhe zhvillimet politike në tremujorin e parë të këtij viti, zhvillimet që kanë ndodhur, ndoshta kanë bërë që në këtë rast po flas për lëvizjet e reja, ose situata e re e krijuar edhe brenda LVV-së, po edhe brenda koalicionit në tre muajt e parë. Tash edhe në raport po pasqyrohem me numra, kështu që ndoshta nuk ka qenë një qeverisje efektive, ose çfarë ne kemi mujt me e pas. Prej muajit prill kemi pa një dinamizim më të madh të proceseve dhe të punëve që veç kanë filluar me u kryer, po e shohim që te të hyrat kemi ulje prej 11.96% në vitin e kaluar, kemi rritje të shpenzimeve, nëse shkojmë te drejtoritë, nuk po dua me e përsëritur se shumë parafolës veç përsëritën. E kam një koment kështu personal te puna e legalizimit të ndërtimeve pa leje. Po më intereson kjo, sepse po e shoh që është zero inkasimi për këtë vit, për dallim prej viteve të kaluara që ndonëse nuk ka pas ndonjë inkasim të madh, mirëpo prapë i kemi pas disa vlera. Ky proces pse ka stagnuar, dhe pse nuk po vazhdon me u zhvilluar më tutje? Si grup në parim po mendoj edhe pse nuk është që kërkohet shumë votim këtu, mirëpo ne do ta përkrahim këtë Raport financiar dhe shpresojmë që deri në fund të vitit do të përmbushet buxheti i këtij viti, ndonëse trendi është jo i mirë për këtë fillim.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë.

E hapim diskutimin për të gjithë diskutuesit e paraqitur me radhë.

Fiknete Bejta.

**Fiknete Bejata:** Faleminderit.

Sipas këtij Raporti financiar të tremujorit të parë të vitit 2018, ne kemi vërejtur se janë paraqitur, ose kemi pas një shkallë të realizimit të projekteve kapitale, si dhe vjelja e të hyrave të planifikuara nuk është e kënaqshme, se nuk ka nivel të kënaqshëm. Kemi vetëm 2.61% realizim të buxhetit për shpenzime kapitale me rënie të realizimit të të hyrave vetjake në 11.96%, ose më pak për 737.000 euro. Në fakt krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017, kemi evidentuar rritje të shpenzimeve për mallra dhe shërbime, me theks të veçantë rritje të pagave dhe mëditjeve për 3.02%. Ky ekzekutim i dobët i buxhetit do të rezultoi në të ardhmen në tremujorët e tretë, tremujorët e vitit 2018, me shfrytëzim joefikas të fondeve në dispozicion, si dhe do të reduktoi efektivitetin e planeve të shpenzimeve sipas programit. Në këtë tremujor gjithashtu për të përmirësuar performancën financiare në disa raste, ka gabime mendoj të qëllimshme numerike, gabime përllogaritëse. Në raport nuk paraqiten disa projekte që kanë qenë të bartura në TM4 e 2017, dhe nuk shpjegohet arsyeja pse nuk janë realizuar projektet, dhe pse po anulohen disa projekte, pasi po fillojnë së zbatuar. Ku ka ngec planifikimi, pastaj kemi të hyra më pak nga arkëtimi i qirasë për pronat e komunës, thash për të shpjeguar shpjegimet pse duhet të jenë në raportet financiare, sepse kjo është edhe me standarde të raportimit financiar. Për komunën mos përmbushja e programeve për investime kapitale do të rezultoi në realizimin e më pak projekteve. Pagesat e ekzekutuara sipas vendimeve gjyqësore dhe nenit 39.2, të Ligjit për menaxhimin e financave publike, janë domethënëse për buxhetin edhe në këtë tremujor, edhe këto pagesa, sidomos me përmbarues do të ndikojnë në lëkundjen e bilancit buxhetor. Mos angazhimi i Zyrës ligjore të komunës për të kontestuar dhe trajtuar vendimet aty ku ka bazë ligjore, rrezikon dëmtimin e buxhetit dhe pagesa të tjera administrative, kjo rrit rrezikun për pagesa jashtë kodeve të planifikuara dhe mos realizimin e projekteve për shkak të ri destinimit të shpenzimeve buxhetore. Pozicionet buxhetore do të ri destinohen me gjasë, pasi që kemi shpenzime të mëdha tek disa zëra financiar, siç ishte rasti i shpenzimeve për udhëtim, akomodim dhe mëditje jashtë vendit, të cilat janë rrumbullakësuar në 31.8% të shpenzuara, apo pozicioni tjetër shpenzimet tjera prej 50.000 euro të buxhetuara, janë shpenzuar 34%, që i bie që këto dy kategori buxhetore, ose po i shërbejnë kodeve tjera për ti mbuluar këta punëtorë që nuk janë deklaruar si punëtorë me kontrata të veçanta. Ky Raport financiar është i përmbledhur në mënyrë të përgjithësuar dhe jo i detajizuar, pra mungojnë shpjegimet për pozicionet buxhetore, p.sh. pse kemi mungesë të realizimit të projekteve kapitale, edhe pse janë të kontraktuara në mbi 14.000.000 euro. Praktikisht Kuvendi në një raport të tillë nuk ka informacion mbi shpenzimin e parasë publike nga ekzekutivi në mënyrë të detajizuar, e cila është edhe obligim ligjor dhe standard i pasqyrimit financiar. Kjo qeveri nuk po krijon praktikë të raportimeve të detajizuara mbi shpenzimet e drejtorive, në të cilën parafolësja ime e pozicionoi se ky raport është diçka më i mirë, është raport i ambalazhuar më mirë, por me përmbajtje me shumë deficite të larta. Pra nuk kemi raport të detajizuar mbi shpenzimet e drejtorive, në karburante, dreka, darka dhe të mbuluara me mos punën, duke mbuluar kështu mos punën e drejtorive. Ky nivel i raportimit është apo

përfshirjes së Kuvendit në mbikëqyrje të shpenzimeve të buxhetit komunal, ka kaluar në praktika të zakonshme. Këtë raport unë si asamblistë nuk do ta votoj, dhe shpresoj që kolegët ta kundërshtojnë, pasi që nuk praktikohet të kemi një raport me mungesa të mëdha dhe mos orientim në zhvillim, por vetëm në shpenzim.

Faleminderit.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë.  
Shefki Gashi.

**Shefki Gashi:** Unë nuk kam çka i shtoj këtyre çka i thanë parafolësit e LDK-së, me përjashtim që po ma merr mendja që është bërë një, nuk ka qenë praktik përpara që të gjithë suksesin ose mos suksesin ta grumbullojnë në një vend të gjitha drejtoritë. Është dashur me pas raport të posaçëm secila drejtori, sa ka pas buxhet, cilat kanë qenë programet e saj, sa e ka realizuar programin për tre muaj ditë. Tash nuk e di sa kanë kompetenca drejtoritë, a kanë kompetenca fare, apo nuk kanë hiq, apo janë të grumbulluara krejt kompetencat te kryetari, dhe aty mundemi me pa se cili prej këtyre kuadrove në Komunën e Prishtinës tregon performancë pozitive. Këtu nuk po dihet, këtu janë përzier të gjithë në një vend, dhe nuk e dimë sa ka sukses në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, sa ka sukses në shëndetësi, sa ka sukses në urbanizëm, e ku ta di unë, me përjashtim të këtyre taksave që janë të urbanizmit pak më të mëdha, përndryshe nuk e ke një pasqyrë reale të punës së drejtorive, që është obligim dhe është punë që këta njerëz që janë në këto drejtori duan me pas dhe me e ditur performancën e tyre, deri ku kanë mbërri në tremujorin e parë, të dytin, të tretin e në të katërtin. Ndoshta dikush prej tyre merr ndonjë vërejtje prej neve, ka edhe që nuk e marrin, por po supozojmë se dikush dikujt i ndihmojmë me këto diskutime, ndoshta që nuk kanë nevojë, por megjithatë është dashur me qenë një raport i veçantë për secilën drejtori veç e veç, deri ku ka mbërri për tremujorin e parë. Gjithashtu u përmend edhe çështja e ndërmarrjeve, është dashur shkarazi me e përmendur edhe punën e ndërmarrjeve publike, për këta tre muaj ditë, sikur që është rasti p.sh. të "Pastrimi" atje, ajo ka qenë një ndërmarrje shumë e suksesshme në inkasimin e mjeteve, kurse këtu ka mbetur shumë keq inkasimi i mjeteve, kur e ka marrë kompetencën komuna, dhe me e bërë një krahasim se çka mundet komuna me iu ndihmuar, dhe çka mundet komuna me ju lejuar atyre kompetenca për zhvillim të mëtutjeshëm. Prandaj është mirë që të shtohet një detaj, një raport më detaj për secilën drejtori veç e veç.

Ju faleminderit.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë.  
Egzon Azemi.

**Egzon Azemi:** Faleminderit kryesues.

Raporti megjithatë me të gjitha kritikën që mund ti kemi, është shumë më pozitivë se sa raporti i kaluar, kështu që për këtë meriton me e lavdëruar drejtoreshën në këtë rast. Mirëpo çka më ka ra në sy këtu dhe çka e kam vërejtur si shqetësim, është që taksa për shfrytëzimin e sipërfaqes publike ka rënë në mënyrë drastike në të hyrat që i ka sjell komunës, nga viti 2017, kemi pas 99.699 euro të hyra nga taksat e shfrytëzimit të sipërfaqes publike, ndërsa tash shuma ka ra në vetëm 47.953 euro. Është pyetje për ekzekutivin se pse ka ndodhur kjo, kur në

tremujorin e njëjtë të po këtij viti, të vitit të kaluar në fakt dhe gjithashtu edhe të vitit 2016, të hyrat kanë qenë shumë më të larta? Gjithashtu shqetësim tjetër është siç u përmend edhe më herët te mallrat dhe shërbimet, në një farë forme kjo po i bie të jetë tash një qeveri e luksit, e cila i ka arritur pothuajse për 1.000.000 euro shpenzimet në mallra dhe shërbime. Në vitin e kaluar janë shpenzuar 1.888.150 euro në mallra dhe shërbime, ndërsa në tremujorin e njëjtë të këtij viti janë shpenzuar 2.615.897 euro. Kërkojë edhe për këtë çështje sqarim, pse ka ndodhur një rritje kaq e madhe te mallrat dhe shërbimet, dhe po e përsërisë prapë pse kanë rënë në mënyrë kaq drastike, të hyrat nga shfrytëzimi i sipërfaqeve publike.

Faleminderit.

**Kryesuesi:** Faleminderit.

**Arbenia Murseli.**

Të nderuar të pranishëm, i nderuari kryesues, nënkryetar, drejtor, kolegë asamblist, përfaqësues të mediave.

E analizova raportin financiar buxhetor për këtë tre mujor, dhe ajo që më bëri përshtypje është trajtimi i kafshëve endacake për të cilat buxheti është njëqind mijë euro. Janë alokuar pesëdhjetë mijë euro, ndërkaq janë shpenzuar deri më tash gati 19 mijë euro.

Ajo që më intereson ta di është se cilat janë veprimet konkrete që janë ndërmarr për qentë endacak, cila është kompania që është kontraktuar për trajtimin e tyre dhe cilat janë rezultatet deri më tash. Duke e ditur se ata po e shohin çdo ditë jo më rrallë përkundrazi ndoshta edhe më shpesh të cilët po vazhdojnë me shërbyer si rrezik për jetën e qytetarëve.

Faleminderit.

**Kryesuesi**

Faleminderit shumë.

Nol Nushi e ka fjalën.

**Nol Nushi**

Po ndoshta vetëm një korrektim tek kjo pika pse ka të hyra më pak për këtë tre mujor, më duket se është manipuluar pak. Nëse mundem të them kushtimisht, se nëse e shohim tek faqja pesë të hyrat paraprake, të hyrat vetanake për tremujorin e parë 2018, të gjithë zërat të cilët praktikisht janë kompetencë e Komunës kanë ngritje përveç p.sh shpronësime ku në vitin 2017, kemi pasur 800 mijë euro e këtë vit nuk kemi, ama kjo nuk është kompetencë e Komunës. Jo nuk e lidha me ty. p.sh. shpronësim në vitin e kaluar ke mundur me pasur sepse Qeveria ka vendosur me ndërtuar një autostradë diku qysh ndërtojnë këta çdo vit, edhe ka qëlluar nëpër tokat e Komunës dhe detyrimisht e ka shpronësuar Komunën me 800 mijë euro, kjo nuk është as faj e as meritë e Komunës. Pra nuk ka zvogëlim të hyrave, thjeshtë nuk është bërë një shpronësim prej Qeverisë, sepse nuk ka pasur nevojë me u bërë sepse nuk është ndërtuar asgjë për me u shpronësuar. Nëse kemi fatin marohet edhe ndonjë autostradë e rrethojmë Prishtinën me autostrada besoj na rritet buxheti, por nuk po dyshoj se ka me ndodhur kjo.

Për ndryshe tatimi në pronën e pa luajtshme rritje shumë mirë varret prej Komunës, por taksa për certifikata dhe dokumente zyrtare nuk varet prej Komunës, por varet prej kërkesës që ka për ato dokumente, pra ajo mundet mos me pasur hiq nuk është faji i



Komunës, askush nuk ka dashur me nxjerr certifikatë, nuk mundemi me i shti qytetarët me ardhur me zorë me nxjerr certifikatë, ama tatimin në pronë e kanë detyrim. Me nxjerr certifikatë nuk e kanë detyrim të Komunës përveç nëse duhet me e kryer ndonjë shërbim me atë dokument.

Mbeturinat po shihet se kanë filluar me u inkasuar.

Është e gëzueshme lajmi për Bibliotekën dhe Teatrin Kombëtar që janë rritur të hyrat veç financiarisht tregon se ka interesim edhe për Teatër, edhe për Bibliotekë edhe kjo vjen prej kushteve të përmirësuar në këto dy institucione që i ka bërë kjo qeverisje.

Donacionet janë rritur 800% po thotë këtu prej 8 mive kanë kaluar në 70 mijë, edhe ky është lajm i mirë.

E për me u ndërlikur me Egzonin unë pajtohem që nëse ka ra inkasimi edhe janë për të njëjtat sipërfaqe të lejuara publike është problem, përndryshe duhet me shikuar ndoshta qeverisja komunale nuk ka dhënë leje. I ka zvogëluar hapësirat publike që shfrytëzohen dhe i ka kthyer në parqe p.sh. edhe normalisht që këtu menjëherë kthehet në më pak të hyra, këtë nuk e di por po bëjë supozim.

Kështu që kisha pasur qejf se nëse është e kundërta ajo që po them unë është shqetësuese edhe mendoj se duhet me realizuar më shumë të hyra nëse vazhdojmë me të njëjtat sipërfaqe të dhëna në shfrytëzim sikurse në tremujorin e parë, më falni në 2017-in.

Faleminderit.

### **Kryesuesi**

Egzoni është paraqitur kjo d.m.th si replikë.

### **Egzon Azemi**

Desha të them që nuk është që ka ndodhur një diçka që Noli po e supozon kishte me qenë mirë që nëse ishin liruar disa hapësira publike dhe ishte ndërtuar ndonjë park apo diçka, atëherë as që e kisha përmendur këtë pikë. Por përkundrazi shumë kafeteri veç i kanë mbushur trotualet më shumë se sa kurrë më parë. Ndoshta dua të them se veç ka ndodhur më shumë, ndoshta shfrytëzim i pa ligjshëm i hapësirave publike se sa ka qenë mandatet e kaluara, në vitet e kaluara kur i është ndarë shfrytëzimi i hapësirës publike lokaleve ose bizneseve të ndryshme dhe me këtë e kanë detyruar me një pagesë takse. Kështu që kërkoj një përgjigje nga dikush nga ekzekutivi për këtë çështje.

Faleminderit.

### **Kryesuesi**

Kundër replikë Nol Nushi.

### **Nol Nushi**

Ka shfrytëzim të jashtë ligjshëm, shumë kam qejf me e cek me e qar kërkesën me shkuar bashkë me fotografuar ose me rrënuar ose me e kryer.

Nuk mundemi me fol secili këtu ka shfrytëzime, jo ky tha ka sigurt, nëse thotë supozoj që ka pajtohem plotësisht nëse nuk thotë supozoj është fakt. Egzoni po e din që dikush është duke e shfrytëzuar jashtë ligjshëm pronën e Komunës së Prishtinës, të cilën ne jemi thirrur me e mbrojtur.

Nëse nuk e lajmërojmë jemi bashkë fajtor, nëse e lajmërojmë edhe nuk rregullohet i ka fajet qeverisja komunale.

Për atë jam që maksimalisht sa herë të kemi kësi fakte, kësi dyshime me i qar deri në fund. Se këtu mundemi me thënë secili valla krejt janë duke ndërtuar pa leje në Prishtinë,

kur shkon e i këqyr krejt kanë leje ndërtimi edhe konfrom Ligjit. Nuk është fer me fol kështu, se jemi duke e marr nëse thotë supozim pajtohem plotësisht.

Unë e thash p.sh nuk thash asnjëherë sigurt që është ndërtuar farë. Mirë cila është e uzurpuar, cila jo vetëm duhet me treguar saktë filan lokali me parcelën kaq e ka uzurpuar pronën publike.

Merre fjalën, nuk bënë me thënë të gjitha sapo the se janë duke u shfrytëzuar ilegalisht, ose thuaj filan lokali dyshohet që në rrugën B e ka uzurpuar pronën publike dhe kërkoj nga inspektoriat me shkua ose nuk foli muhalife këtu.

**Kryesuesi**

Kundër replikë Egzon Azemi.

**Egzon Azemi**

Unë e kuptoj rolin e Nolit që është duke e luajtur rolin e gardianit të Komunës këtu mirëpo unë nuk jam inspektorë për me u marr me këto çështje.

Ka shumë uzurpime në disa pjesë të Prishtinës, edhe shifrat vetë po tregojnë që nuk ka leje të mjaftueshme për shfrytëzim të sipërfaqes publike. Prandaj nëse ti nuk ju ke dhënë paraprakisht leje, normal që ka me pasur edhe shfrytëzim ilegal të këtyre sipërfaqeve. Kështu që nuk ka nevojë me e mbrojtur askënd në kësi procese negative, përkundrazi kur janë shifrat kaq të qarta që po dëshmojnë që ka të hyra. Shumë më pak duhet edhe ti si asamblist për shkak se këtu ke hyrë si asamblist i Vetëvendosjes fillimisht kështu që parimisht duhet këtë me e bërë me kërkuar sqarim të paktën pse ka ndodhur një gjë e tillë, pse ka kaq pak të hyra edhe pse janë rritur kaq shumë shpenzimet në mallra dhe shërbime.

Faleminderit.

**Kryesuesi**

Faleminderit.

Sokol Havolli e ka fjalën.

**Sokol Havolli - LDK**

Faleminderit kryesues.

Të nderuar kolegë edhe unë do ta bëjë një koment në fillim që për nga cilësia raporti është shumë më i mirë kundër atij çka ka qenë herën e kaluar, që në fakt ka qenë një raport i tmerrshëm herën e kaluar. Mirëpo edhe ky raport ka ende hapësirë për përmirësime sidomos në pjesën e interpretimit dhe sqarimit të zërave buxhetorë.

Megjithatë unë e kuptoj kësaj radhe drejtorinë që e ka përgatitur apo edhe z. Ahmeti sepse ky është raporti i Kryetarit.

Prandaj edhe te interpretimi ka mbetur mangësi, sepse nuk ka pasur çka të interpretoj çka është e vërteta, e kemi një gjendje relativisht të keqe në qytetin e Prishtinës sa i përket realizimit të buxhetit. Është për keqardhje kur i shohim investimet kapitale me një normë tejet të ulët të realizimit, subvencionet dhe transferet po ashtu me rrënje të realizimit. Ndërsa natyrisht sa vërejtëm në disa prej këtyre zërave nuk janë kursyer shumë nga realizimi i pagave dhe mëditjeve, por po ashtu edhe në realizimin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime, përfshirë edhe ato që quhen si shpenzime të lluksit, e ndër to çka më ra në sy është edhe pagesa e qirave diku për automjete p.sh 55 mijë euro deri tash janë 44 mijë euro. Mbante me dhjetëra konferenca kryetari i Prishtinës për një automobil

pasuri e Komunës, nëse po shitet apo nuk po shitet, ndërsa ne sot e kemi vetëm në këta tre muaj realizim 44 mijë euro qira për automjete.

Megjithatë nuk dua të ndalem shumë në zëra specifik, por ndoshta të paktën ta diskutojmë edhe kontekstin dhe dëmin që i shkaktohet qytetit të Prishtinës nga mos realizimi i buxhetit, sidomos nga mos realizimi i investimeve kapitale.

Njëra prej problemeve kryesore të qytetit të Prishtinës është mos zgjerimi i saj në aspektin infrastrukturor edhe krijimin e kushteve për zhvillimin ekonomik. Për deri sa në vitin e kaluar kemi pasur realizim diku pak përmbi 50% të investimeve kapitale, sivjet shifrat janë edhe më dëshpëruese se nuk ka shpresë për përmirësim të jetës së qytetarit dhe kushteve të zhvillimit të ekonomisë në qytetin e Prishtinës.

Kjo sigurisht nuk gjeneron vende të reja të punës në qytet, jo të gjenerohen përmes investimeve kapitale. Të gjithë e kemi të qartë parimet kryesore të ekonomisë, por investimet kapitale krijojnë kushte shumë të mira për biznesin që me u zhvilluar vetë edhe më tutje. Kjo gjë nuk është duke ndodhur pasi që bizneset po ballafaqohen madje as me kushte aq të mira sa kanë qenë para 5-6-7 viteve, po e themi edhe ato kanë degraduar sot i kemi rrugët e qytetit në gjendje të mjerueshme duke i harrnuar ashtu po them me disa kupëza. Pastaj edhe rregullimi i disa rrugëve menjëherë fillon të ballafaqohen me prishje sikur që është rruga prej rrethit deri te spitali që menjëherë veç ka filluar me pasur atë efektin çfarë ka qenë po thujse edhe para 3-4 jave përpara se të rregullohet.

Por çka është shumë e rëndësishme është se planifikimin e këtij buxheti nuk ka asgjë konkrete e cila kishte me zhvilluar qytetin e Prishtinës. Ne çdo ditë këtu kur ballafaqohemi me ekzekutivin e Komunës na njoftojnë se si janë duke u planifikuar projektet e mëdha siç është Unaza e qytetit e të gjitha këto, mirëpo këto askund nuk janë të reflektuara në dokumentet konkrete dhe qyteti i Prishtinës në fakt po ballafaqohet me një recesion që po e shkakton sigurisht edhe përtej qytetit të Prishtinës. Për fat të keq është gjendja e realizimit e të gjitha këtyre projekteve që ka nevojë qyteti i Prishtinës, dhe e kemi pothuajse një situatë të stagnimit të plotë e cila në fakt reflektohet edhe vetë nga aktivitetit i kryetarit çoftë në asamble, çoftë në aktivitetet tjera të tij publike.

Faleminderit shumë.

**Kryesuesi**

Faleminderit.

Fjalën e ka Besnik Mujeci.

**Besnik Mujeci - LVV**

Përsëritje për të gjithë.

Unë i pata dy vërejtje këtu, të hyrat nga kodi 18166 taksa dhe shfrytëzimi i sipërfaqeve publike. Duke pasur parasysh se tre mujorët e parë të vitit janë zakonisht kushtet atmosferike janë të këqija dhe zakonisht ndodh që të ketë më pak të ardhura nga taksa, duke pasur para sysh se viti 2016 dhe 2017, kushtet atmosferike kanë qenë më të këqija dhe të ardhurat janë më të mëdha në krahasim me tre mujorët e parë të viti 2018 dhe vërehet një rrënjë drastike nga vjelja e taksës.

Po ashtu desha të lidhem me mbeturinat që tha parafolësi se tre mujorët e parë të vitit kanë qenë 600 mijë euro. Ato të ardhura kanë ardhur nga Kompania Rajonale "Pastrimi", e cila ka vjel të ardhura nga gjashtë komunitat e tjera të rajonit të Prishtinës, dhe këto janë të ardhura vetëm nga amvisëritë e jo nga bizneset. Këto janë të ardhura vetëm nga

amvisëritë në qytetin e Prishtinës dhe nuk është tregues kredibil me tremujorëshin e parë të vitit 2017 dhe 2018.

Kaq pata.

Faleminderit.

**Kryesuesi**

Faleminderit.

Fjalën e ka Mimoza Sylejmani.

**Mimoza Sylejmani - GP**

Faleminderit kryesues.

Përshëndetje për të gjithë.

Vetëm desha pasi që drejtori i Urbanizmit nuk po e shoh se është këtu, një plotësim apo një informatë, Ligji për legalizim që tha kolegu nuk ka të hyra për shkak të ndërtimeve pa leje. Ligji për legalizim ka përfunduar në Mars të vitit të kaluar, është bërë një draft dokument i cili tashmë gjendet edhe në Kuvendin e Kosovës. Po sa të jetë gati dhe të miratohet në Kuvendin e Kosovës atëherë do të fillojmë prapë me legalizimin në komunën e Prishtinës.

Faleminderit.

**Kryesuesi**

Faleminderit.

Agim Gashi e ka fjalën.

**Agim Gashi**

... vetëm një sqarim lidhur me të hyrat nga mbeturinat, është e mundur që mos të jetë i saktë statistika që e dhashë, megjithëse unë i kam kërkuar të hyrat vetëm nga territori i komunës së Prishtinës. Nëse ato janë dërguar janë dërguar gabimisht nga shërbimi përkatës i ndërmarrjes, por mos të harrojmë se aksionet në atë ndërmarrje Prishtina i ka 78%. Nëse shumica dërmuese e të hyrave i takon komunës së Prishtinës dhe në këtë relacion nëse zbërthehet shihet se të hyrat janë shumë më të ulëta. Unë nuk po akuzoj se çdo ndryshim mund të ketë problemet e veta, por ajo është një fushë e cila të hyrat janë të garantuara. Prandaj mos punën mos të përpiqemi ta arsyetojmë me diçka që nuk ekziston.

**Kryesuesi**

Faleminderit.

Nuk kemi të lajmëruar dikë tjetër nga anëtarët e asamblesë.

Drejtoresha e financave e ka fjalën.

**Valbona Makolli - drejtoreshë e Drejtorisë së Financave**

Faleminderit kryesues.

I nderuari kryesues, kolegë drejtorë, edhe ju të gjithë asamblist.

Unë vetëm desha me ju falënderuar për kritikën e juaja profesionale që i keni dhënë edhe ato kritika kanë ndikuar tek unë dhe te të gjithë kolegët e mi që me e bërë një përmirësim më të mirë të raportit.

Ky raport është bërë duke u bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, i kemi shti ato të dhëna ashtu si janë në Ligj.

Desha me ju përgjigj shumë shkurt atë..... asamblistët që parashtruan disa pyetje, p.sh Plani i prokurimit, me Ligj nuk është i paraparë një Plan i prokurimit por në rregull unë po e tregoj atë çka në të cilin jemi bazuar edhe me Ligj nuk është i paraparë një Plan i

prokurimit por mundemi me e bërë nëse bëhet ndonjë pikë për ndonjë mbledhje të ardhshme mundemi me e paraqitur ndonjë Plan së bashku me drejtoritë përgjegjëse me e parë se deri ku jemi.

Sa i përket pyetjes së dytë, bartjen e mjeteve të hyrave vetanake do të jetë pikë e rendit të ditës në mbledhjen e ardhshme. Ju ka paraqitur kryetarit i kemi ato obligimet të cilat kanë përcjell prej viteve të kaluara, mirëpo ajo do të del para juve në mbledhjen e ardhshme si pikë e rendit të ditës.

Sa i përket detajeve të shpenzimeve, ajo asamblistja që e bëri desha me e njoftuar se në këtë Raport nuk i kam përfshirë se nuk është paraparë me Ligjin për, neni 46 i këtij Ligji, mirëpo raportet mujore që janë të publikuara në WEB faqe janë detaje për secilën nga shpenzimet të cilat janë bërë.

Mirëpo nëse e shihni të arsyeshme mundem prapë me diskutuar por është një volum bajagi i madh e ato janë të ndara muaj për muaj d.m.th janë të ndara muaj për muaj që me hy për secilën kategori të mjeteve qysh janë bërë shpenzimet.

Por nuk kam mundur ti ndajë drejtoritë se në krejt drejtoritë shpenzimet shkojnë por në kuadër,... Eman shpenzimet hyjnë të mallrave dhe transfereve hyjnë në Drejtorinë e Administratës, d.m.th sipas grantit të përgjithshëm qeveritar.

Kurse tek shpenzimet kategoria ekonomike e investimeve kapitale i kam ndarë sipas drejtorive d.m.th tek ky Raporti që e kam paraqitur.

Shqetësim edhe për neve janë detyrimet kontigjente, të cilat i kemi diskutuar edhe më herët, në Raport kam paraqitur që janë 288 lëndë prej detyrimeve kontigjente, sipas Departamentit të Avokaturës së Komunës së Prishtinës, vetëm tridhjetë prej tyre kanë ndikim financiar në buxhetin që është mjaft shqetësuese edhe është vlera shumë e madhe, mirëpo të tjerat janë me karakter tjetër d.m.th pronësore dhe çështjeve tjera.

Kurse sa i përket pagave dhe mëditjeve përveç atyre punëtorëve që i kemi paraqitur që janë me kontratë të veçantë pagat dhe mëditjet janë të caktuara njëherë në vit edhe atë prej Qeverisë, edhe ato nuk mundemi me i lëviz edhe nëse ka ndonjë lëvizje edhe në muajt e ardhshëm edhe në Raportet tjera do të paraqiten ashtu siç janë, d.m.th qysh merren prej personelit.

Diçka tjetër nuk kam janë kolegët e mi që do të ju përgjigjen pyetjeve, por prapë po ju them jam e hapur për çfarëdo kritike profesionale, se qëllimi i ynë dhe i juaji që në emër të qytetarëve të del një Raport i pranueshëm për krejt qytetarët në bashkëpunim me të gjithë ne çka jemi në emër të tyre.

Faleminderit.

**Kryesuesi**

Faleminderit.

Urdhëro Agim.

**Agim Gashi**

Ne jemi shumë të vetëdijshtëm që ky është Raport financiar, dhe se në adresën e juaj nuk kemi vërejtje sepse ju keni bërë pasqyrimin real të asaj çfarë ekziston.

Por meqenëse për bashkëpunimin mes kryetarit, qeverisjes dhe Kuvendit është më shumë dimensional se sa një Raport i pasqyruar numerikisht, këtu do duhej të kishte informacione shtesë për shërbimet e veçanta siç është Zyra e Prokurimit, sepse Zyra e prokurimit është promotori i të gjitha politikave që kanë të bëjnë me financat, dhe ne i

kemi informatat se sa publikime janë bërë deri më 31 mars. Janë 51 publikime edhe ajo të vlerave të vogla e jo të vlerave të mëdha por nuk kemi arritur me i marr sa janë ato vlera nga planifikimi.

Kjo unë nuk po them pse e kemi zënë bishtin me derë dhe po e përsërisë disa herë por pse është shumë e nevojshme që të dimë se në çfarë gjendje është ajo zyrë sa po i paraprinë politikave realizuese të qeverisë komunale.

Prandaj ka qenë dashur me një fjali ose dy fjali për ndërmarrjet publike, një përshkrim të përgjithshëm se cila është gjendja aktuale dhe çka e ndryshon atë tremujorin e vitit të kaluar, sepse ato janë pasuri e madhe e Komunës së Prishtinës.

Faleminderit.

**Kryesuesi**

Faleminderit.

Urdhëro Drilon.

**Drilon Pireva**

Vetëm një sqarim në shpejtësi.

Me Ligj të prokurimit krejt autoritetet kontraktuese e kanë për obligim Planin e prokurimit me e bërë publik. Ajo bëhet në KRPP në fillim të vitit, kështu që planet e prokurimit i gjen në një veb-faqe në KRPP. Ajo është shumë e thjesht nuk duhet me qenë pjesë e Raportit financiar. Edhe tek bartja që tha, edhe tek bartja është pozicioni shtatë te puna e suficitit thotë që të hyrat vetanake të pa shpenzuara nga viti i mëhershëm në shumën prej 13 milion, janë për bartje në vitin vijues 2018. Këto mjete na paraqiten si suficit buxhetor, por janë obligime të kontraktuara d.m.th janë punë që janë duke u realizuar edhe kanë me u bërë pagesat këtë vit.

Kështu që edhe punën e bartjes së mjeteve prej vitit paraprak e ke të sqaruar në Raport.

Faleminderit.

**Kryesuesi**

Faleminderit.

Atëherë përgatituni për votim.

Konstatohet se me 20 vota për, 16 kundër dhe 1 abstenim miratohet Raporti financiar të tremujorit të parë (TM1) të vitit 2018.

Shkojmë në pikën e radhës.

**Pika e katërt**

**Propozim vendimi për miratimin e Planit të veprimit për transparencë**

**Kryesuesi**

Fjalën e ka drejtori i Administratës z. Muhedin Nushi.

**Muhedin Nushi – drejtor i Drejtorisë së Administratës**

Përshëndetje për të gjithë.

Para juve është Plani i përpiluar me kujdes Plani i veprimit për transparencë ku janë të definuara njëzet e katër objektiva. Objektivat në të cilat jemi bazuar edhe gjatë vitit 2017, por që kemi dashur thjesht ti zyrtarizojmë ato objektiva duke u bazuar edhe në veprimtarinë të cilën jemi duke e ndërmarrë edhe gjatë këtij viti.

Thjesht është një plan jashtëzakonisht mirë i përgatitur objektivat janë qartë të definuara, edhe sa i përket transparencës mendoj se si Komunë së paku mundemi me u mburr me transparencën e deri tashme krahasuar me komunat e tjera.

Faqe 30 nga 50

Kaq shumë shkurtimisht është.

**Kryesuesi**

Faleminderit drejtor.

Urdhëro Halim.

**Halim Halimi - LDK**

Propozim vendimi për miratimin e Planit të veprimit për transparencë për vitin 2018, e kemi pasur edhe në Komitet për Politikë dhe Financa dhe atje ne kemi thënë veç fjalë më të mira. Faktikisht nuk kemi çka të ndryshojmë nga se në këtë Plan të veprimit për transparencë veç janë përshkrime të marra nga Ligji që nuk mundemi ti ndryshojmë. Vetëm kërkojmë nga ekzekutivi që ti përmbahet këtij Plani dhe ne do ta përkrahim si LDK.

**Kryesuesi**

Faleminderit.

Urdhëro Leonora.

**Leonora Shabani- Bajraktari - LVV**

Përshëndetje për të gjithë.

Në fakt miratimi i Planit të veprimit për transparencë është jashtëzakonisht i mirë pritur nga LVV-ja.

Gjithashtu më la përshtypje 1,6 edhe 15, ku njoftimet për mbledhjet e Kuvendit dhe Komiteteve të informohen edhe qytetarët, ku në fakt ne kemi pasur pak problem për Komitete me u njoftuar më herët edhe si asamblist. Kjo është jashtëzakonisht e mirë pritur që do të njoftohemi më herët edhe për komitete, edhe asambleja por gjithashtu edhe qytetarët.

Më la përshtypje gjithashtu edhe pika gjashtë ku do të bëhet publikimi i akteve të miratuara, ku ne ende e kemi një problem ku rekomandimet e dala për seancën e jashtëzakonshme për 8 mars, ende ato rekomandime nuk kanë dalë në WEB faqen e Komunës së Prishtinës, dhe ne shumica nuk i dimë çka përmbajnë ato dhe çfarë rekomandime janë ato. Por në fakt ato janë dorëzuar në kryesinë e Kuvendit dhe nuk janë bërë transparente ende.

Më së shumti më pëlqeu pika 15 ku transparencë e plotë në punësim, po aty është parë që është mirë që mos të ketë jo vetëm në Drejtorinë e Arsimit, se vetëm Drejtoria e Arsimit e ka tamam publike konkursin për punësim, por të jetë në të gjitha drejtoritë kjo transparencë. Por gjithashtu edhe në Kuvend dhe në Komunën e Prishtinës të jenë sa më transparente të gjitha konkurset në Komunë dhe në të gjitha drejtoritë.

Ju faleminderit.

**Kryesuesi**

Faleminderit.

Urdhëro Vala.

**Vala Peshku - GP**

Faleminderit kryesues.

Në parim Grupi ynë pajtohet me këtë propozim vendim.

Faleminderit.

**Kryesuesi**

Faleminderit.

Urdhëro Leutrim.

## **Leutrim Rretkoceri - PDK**

Faleminderit kryesues.

Grupi parlamentar i PDK-s e përkrah këtë pikë të rendit të ditës, miratimin e Planit të veprimit për transparencë. Qysh në mbledhjen e parë unë kam kërkuar që të ketë transparencë sa më të madhe si në Ndërmarrjet publike ashtu edhe në funksionimin e administratës së Komunës, dhe këtë propozim do ta votojmë.

Faleminderit.

### **Kryesuesi**

Faleminderit.

Urdhëro Valbona.

## **Valbona Ajeti - AAK**

Edhe Grupi i ynë parlamentar e përkrah në parim këtë propozim vendim. Përshtypje personalisht mua më la transparenca e plotë në punësim tek pika pesëmbëdhjetë, e kam fjalën për Drejtorin e Arsimit. Personalisht në konkursin e fundit në arsim pikët që më janë dhënë nga data baza në veb-faqen Prishtina online, janë tetëdhjetë pikë, por nuk e di, e di që gjysma kanë ardhur prej diplomave e gjysma prej intervistës.

Në qeverisjen e kaluar ka qenë e ndarë data baza se nga kanë ardhur pikët, kurse tash janë pikët e grumbulluara vetëm shkruan tetëdhjetë pikë si total e nuk janë të ndara se nga kanë ardhur ato tetëdhjetë pikë, prandaj më la përshtypje kjo tek punësimi tek Drejtoria e Arsimit.

Faleminderit.

### **Kryesuesi**

Faleminderit.

Urdhëro Vesel.

Vesel a je ti shef i grupit.

Urdhëro Arbenita.

## **Arbenita Murseli - AKR**

Faleminderit kryesues.

Po besoj se do të ishte shumë me vend nëse ky Plan i transparencës do të zbatohet me përpikëri pa u anashkaluar asgjë.

Ndërkaq ato pika ku unë gjeta vërejtje se nuk zbatohen në praktikë është pika e katërt që thotë përgatitja e informatave të mbledhjes së Kuvendit të Komunës, që i bie se menjëherë pas përfundimit të kësaj mbledhjeje duhet të përgatitet një shkresë apo komunikatë zyrtare që të ju dërgohet mediave si dhe të publikohet në faqen zyrtare të Komunës si dhe në faqet tjera sociale.

E një gjë e tillë nuk po ndodh në çdo seancë ose shumë shumë rrallë, e njëjta duhet të ndodh edhe pas mbledhjeve që mbahen nga të gjitha komitetet e Komunës. Gjithashtu nëse në faqen e Komunës klikojmë tek vegëza Kuvendi, më pas komitetet e përhershme, emrat e anëtarëve të këtyre komiteteve janë të vjetrit d.m.th të mandatit të kaluar.

Faqja duhet të rifreskohet dhe të vendosen emrat e atyre anëtarëve që janë tani.

Andaj kërkoj që për hir të transparencës këto mangësi që i përmenda të shndërrohen në përparësi duke i ofruar qytetarit qasje sa më të lehtë për informim të saktë në lidhje me atë se çka zhvillohet në aktivitetet e Komunës.

Në përgjithësi si grup parlamentar e përkrahim Planin e transparencës por duke u bërë edhe këto iniciativat që unë i përmenda pak më herët.

Faqe 32 nga 50



Faleminderit.

### **Kryesuesi**

Faleminderit.

Tani shefat e grupeve e mbaruan, a ka dikush prej anëtarëve të tjerë që donë ta merr fjalën.

Urdhëro Adrian Berisha.

### **Adrian Berisha**

Fillimisht komplimente të jashtëzakonshme për punën e drejtorit Muhedin Nushi, d.m.th për informatë e vetmja Komunë open data, Prishtina online, edhe Gresës që është aty d.m.th unë jam d.m.th komplimentet më të mëdha që i marr prej qytetarëve kur më ndalin në rrugë është për Administratën në Komunën e Prishtinës.

Unë vetëm kisha dashur ti jap disa sugjerime p.sh me u krijua një Plan strategjik për faqet online të Komunës.

Ne dimë se jemi në kohën e rrjeteve sociale dhe po mendoj se kishte qenë shumë mirë me e shikuar mundësinë se qysh me e rritur numrin e ndjekësve në këto rrjete sociale për arsye se Komuna po kryen punë, disa punë d.m.th sidomos kohët e fundit e qytetarët nuk po i dinë këto punë dhe besoj se kishte qenë një kanal shumë i mirë Facebook, Twiter, Instagrami për me i kuptuar këto punë që po i kryen Komuna e Prishtinës. Në këtë rast p.sh ende ka që më pyesin se ku me e nxjerr certifikatën e lindjes, edhe unë çuditem se qysh nuk po e din hala qytetarët këtë mundësi mjaft të mirë që për 30 sekonda mundesh me e nxjerr një certifikatë të lindjes kundrejt Komunave të tjera që duhesh me prituri hala. Një sugjerim tjetër, kisha thënë me u krijuar një platformë online për subvencionet për bujqësi ashtu siç u krijua për Kulturë Rini dhe Sport, p.sh komplimente të jashtëzakonshme ka prej organizatave, prej qytetarëve për këtë mundësi që është krijuar d.m.th transparencë e plotë.

Po p.sh tek subvencionet për bujqësi ka pasur kërkesa prej qytetarëve, prita në rend shumë kishte qenë mirë nëse kishim mundur të bëjmë njëjtë për bujqësi sikur për Kulturë pasi që shumë shpejt po përfundon puna.

Po ashtu kam marr kritika tek subvencionet e Kulturës, Rinisë dhe Sportit tash veç se kanë dal, d.m.th qytetarët po kërkojnë me i dit se kush janë personat të cilët marrin vendime për këto subvencione, pasi që është mjaft e ndjeshme.

Edhe për një festival që tani po mbahet e kishin refuzuar ai festival është shumë i mirë është festival multi-etnik "Erdh lezeti" e ka emrin, bëhet për ditën e Shëngjergjit, është komuniteti rom ka bende të ndryshme, rumune, hungareze, serbe. Edhe tash d.m.th sipas atij i është bërë e pa drejtë edhe dëshironte me e dit se kush janë personat që e kanë marr vendimin për këtë donte vetëm me e dit se pse nuk kanë hyrë deri në Facebook me parë që festivali ka diku rreth 30 mijë ndjekës në Facebook. Pse nuk e kanë parë që vitin e kaluar kanë qenë rreth 10 mijë persona aty gjatë ditës, ka qenë kulturë d.m.th kanë qenë vlerat kulturore të shtetit tonë, muzikë shumë e mirë, rini ka pasur edhe kjo është pak a shumë.

Faleminderit.

### **Kryesuesi**

Faleminderit shumë.

Po drejtor.

### **Muhedin Nushi**

Faleminderit të gjithëve për reagimet pozitive.

Kjo Rregullore, ky Plan i veprimit nuk është përfundimtar, unë pres bashkëpunim nga të gjithë ju. Kudo që vëreni mangësi, kudo që keni kritikë lirisht na u drejtoni jo vetëm mua, normal drejtohuni tek unë ne i kemi ekipe tona të cilat do të intervenojnë menjëherë. Por këto 24 objektiva janë objektiva në të cilat ne jemi bazuar përpara, d.m.th nuk ka objektivë të cilën nuk e kemi përfshirë me të cilën nuk jemi marr në të kaluarën.

Por ndiejeni veten të lirë që këtë Plan të veprimit ta zgjerojmë, ta ngushtojmë, të japim shpjegime tjera në mënyrë që të risim transparencën deri në maksimum.

Kaq kisha.

### **Kryesuesi**

Faleminderit drejtor.

Diskutime tjera po shoh që nuk ka atëherë shkojmë me proces të votimit.

Regjia të lutem.

Shkojmë me votim tash.

Atëherë konstatoj se me 40 vota për, asnjë kundër dhe 1 abstenim miratohet Propozim vendimi për miratimin e Planit të veprimit për transparencë për vitin 2018.

Faleminderit.

Shkojmë në pikën e radhës.

### **Pika e pestë**

**Propozim vendimi për inicimin e binjakëzimit të kryeqytetit të Kosovës me kryeqytetin e "Des Moines" IOWA-së**

### **Kryesuesi**

A ka diskutime.

Shkojmë me grupe parlamentare.

### **Halim Halimi - LDK**

Sa i përket këtij Propozim vendimi ne si LDK e përkrahim d.m.th. çdo binjakëzim, çdo gjë me komunat tjera jashtë vendit.

Faleminderit.

### **Kryesuesi**

Faleminderit.

Dikush tjetër prej grupeve parlamentare.

Urdhëro Vala Peshku.

### **Vala Peshku - GP**

Në emër të Grupit të pavarur po ashtu jemi në pajtim për këtë vendim për nismën e bashkëpunimit ndërkombëtar me qytetin e IOWA-së.

### **Kryesuesi**

Faleminderit shumë.

Urdhëro Leonora Bajraktari.

### **Leonora Shabani- Bajraktari LVV**

Edhe ne si Lëvizje Vetëvendosje e përkrahim iniciativën për binjakëzimin me shtetet tjera.

Ju faleminderit.

### **Kryesuesi**

Faleminderit shumë.

Nga PDK-ja.

**Leutrim Rretkoceri - PDK**

Faleminderit kryesues.

Edhe PDK-ja e përkrah këtë pikë edhe uroj që të kemi sa më shumë pika të bashkëpunimit ndërkombëtar me shtetet mike siç është IOWA.

Faleminderit.

**Kryesuesi**

Faleminderit shumë.

Në emër të AAK-s.

**Valbona Ajeti - AAK**

Edhe Grupi i ynë parlamentar e përkrah binjakëzimin me shtetin e IOWA-s.

**Kryesuesi**

Faleminderit shumë.

Nga AKR - AA.

**Vesël Makolli - AKR - AA**

Edhe ne e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës.

**Kryesuesi**

Faleminderit shumë.

Atëherë shkojmë me votim.

Regjia gati të lutem.

Shkojmë me votim.

Atëherë konstatojmë se me 41 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

A ka mundësi ta bëjë një sqarim të lutem.

Organizata botërore e Shëndetësisë ka kërkuar takim d.m.th me tre drejtorë edhe me shefat e grupeve parlamentare lidhur me një projekt që kanë ata Komuna e Prishtinës do të jetë pjesë e këtij projekti, projekti i qyteteve të shëndetshme.

Takimi është në orën 13:30, ne menduam në ora 13:15 me bërë pauzën në mënyrë që të mos mungojmë edhe në seancë me shefat e grupeve parlamentare.

Kjo është arsyeja pse, ndoshta mundemi me duruar edhe pak.

Në rregull atëherë edhe shkojmë në shtëpi.

A jeni dakord atëherë në parim.

Faleminderit.

Shkojmë në pikën e radhës.

**Pika e gjashtë**

**Propozim vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)**

**Kryesuesi**

A ka diskutime nga grupet parlamentare lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Halim Halimi nga LDK.

**Halim Halimi - LDK**

Propozim vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi unë mendoj se është bërë në bazë të Udhëzimit administrativ për Këshillat komunale për

Siguri në bashkësi, është konformë me dispozitat ligjore kështu që ne nuk kemi vërejtje dhe ne e përkrahim.

**Kryesuesi**

Faleminderit shumë.

Dikush tjetër prej grupeve parlamentare.

Urdhëro Leonora.

Leonora Bajraktari nga Vetëvendosja.

**Leonora Shabani Bajraktari - LVV**

Edhe LVV-ja e përkrah themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

**Kryesuesi**

Faleminderit shumë.

Rifat Deri urdhëro.

**Rifat Deri**

Faleminderit kryesues.

Unë veç këtu një gabim e gjeta te kjo Berkant Jilta përfaqësues i Kishës hebreje, nuk e di që kane hebrejt kishë por kanë sinagogë.

Vetëm thash të mos kalon kjo pa u përmirësuar ky gabim.

Edhe ne si grup parlamentar gjithsesi e përkrahim këtë vendim themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

**Kryesuesi**

Faleminderit shumë.

Atëherë regjia gati për votim.

Ju lutem votojmë tash.

Me 43 vota për, asnjë kundër, 1 abstenim miratohet Propozim vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Shkojmë në pikën e radhës.

**Pika e shtatë**

**Propozim vendimi për themelimin e Komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës**

**Kryesuesi**

Atëherë materialin e keni secili para vetes, atëherë shkojmë me Komitete me radhë.

Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Lidhja Demokratike e Kosovës, dy emra.

**Halim Halimi - LDK**

Faleminderit kryesues.

Ne, unë besoj se propozimin që e ka Grupi parlamentar i LDK-s kanë edhe grupe të tjera që këto komitete, komitetet jo obligative këto gjashtë komitete, anëtarët e komiteteve thonë që të kompensohen, se nëse nuk kompensohen e kanë fatin e komiteteve të viteve të kaluara.

Sa i përket emrave të anëtarëve LDK-ja për Komitetin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale e propozon Haki Dragushën dhe Naime Osmanin.

**Kryesuesi**

Faleminderit.

**Halim Halimi**

Po i lexojmë për të gjitha Komitetet.

**Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport**, LDK-ja propozon Vlora Dumoshi dhe Kushtrim Sopa.

**Për Komitetin për zhvillim ekonomik** propozon Fiknete Bejta dhe Sokol Havolli.  
Për Komitetin për Planifikim, Urbanizëm dhe Kadastër propozon Sami Salihu dhe Mustafë Krasniqi.

**Për Komitetin për Shërbime Publike** propozon Shefqet Osmani, Shefki Gashi dhe Elmira Nikçi- Rexha.

**Për Komitetin për Pronë** propozon Agim Gashi, Jeta Rafuna dhe Milazim Vitija.  
Ju faleminderit.

**Kryesuesi**

Faleminderit shumë.

Egzon Azemi Vetëvendosje.

**Egzon Azemi -LVV**

Kryesues vetëm desha me e kërkuar një sqarim sepse sipas Udhëzimit administrativ për Komitete për funksionimin e Komiteteve neni 3 thotë se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa nuk kanë të drejtë të jenë edhe anëtarë të Komiteteve të tjera. Mirëpo këtu është fjala për Komitetet e përhershme.

Tashmë kur të themelohen këto a konsiderohen Komitete të përhershme dhe a ka ndonjë mundësi me e sqaruar këtë çështje më mirë.

**Kryesuesi**

Jo këto nuk janë Komitete të përhershme Komitetet tjera quhen do të thotë janë të definuara me term juridik edhe nuk ka konflikt interesi.

Përndryshe do ta marrim gjithsesi edhe mendimin e MAPL-s.

Faleminderit.

Propozimet.

Hajde Grupi i pavarur.

**Vala Peshku - GP**

Faleminderit kryesues.

Kështu nuk po e zgjas shumë po filloj menjëherë me propozimet.

**Për Komitetin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale** GP propozon Visare Goranin.

**Për Komitetin për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport** propozon Adrian Berishën dhe në emër të znj. Petrovci, Valbona Petrovci po ashtu si e pavarur.

OK , në rregull kjo e propozon veten.

**Për Komitetin për zhvillim ekonomik dhe rural** propozon Bashkim Behën.

**Për Komitetin për Planifikim urban, kadastër dhe mbrojtje të mjedisit** propozon Mimoza Sylejmanin.

**Për Komitetin për Shërbime Publike** propozon Qëndrim Sahitin dhe Drilon Pireva.

**Për Komitetin për Pronë** propozon Nol Nushin dhe Genc Sherifin.

Faleminderit.

**Kryesuesi**

Faleminderit shumë.

Urdhëro Leonora.

**Leonora Shabani- Bajraktari – LVV**

**Për Komitetin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale** LVV propozon Vjosa Hamitin.

**Për Komitetin për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport** propozon Leonora Shabani Bajraktarin.

**Për Komitetin për zhvillim ekonomik dhe rural** propozon Eman Rrahmanin.

**Për Komitetin për Planifikim urban, kadastër dhe mbrojtje të mjedisit** propozon Mirsad Vitija.

**Për Komitetin për Shërbime Publike** propozon Egzon Azemin.

**Për Komitetin për Pronë** propozon Besnik Mujecin.

**Kryesuesi**

Faleminderit shumë.

Nga PDK-ja.

**Leutrim Rretkoceri PDK**

Përshëndetje.

Propozimet tona janë si vijon.

**Për Komitetin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale** PDK-ja propozon Kumrie Shabani.

**Për Komitetin për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport** propozon Florida Canollin.

**Për Komitetin për zhvillim ekonomik dhe rural** propozon Blerand Stavilecin.

**Për Komitetin për Planifikim urban, kadastër dhe mbrojtje të mjedisit** propozon Uran Ismailin.

**Për Komitetin për Shërbime Publike** propozon Leutrim Rretkoceri.

**Për Komitetin për Pronë** propozon Migjen Shalën.

**Kryesuesi**

Faleminderit.

Nga AAK-ja.

**Valbona Ajeti AAK**

**Për Komitetin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale** AAK-ja propozon Suzan Kika.

**Për Komitetin për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport** propozon Valbona Ajeti.

**Për Komitetin për zhvillim ekonomik dhe rural** propozon Yll Bogaj.

**Për Komitetin për Planifikim urban, kadastër dhe mbrojtje të mjedisit** propozon Sokol Berisha.

**Kryesuesi**

Faleminderit shumë.

Nga AKR – AA Vesel Makolli.

**Vesel Makolli – AKR – AA**

Ne që biseduam më herët kryesues e kemi përfaqësuesin në Komitetin për Shëndetësi e deshëm që përfaqësuesi ynë nga Shëndetësia të kaloj në Arsim dhe Kulturë te bëjmë një ndërrim.

Andaj propozoj që Arbenita Murseli të jetë në **Komitetin për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport**, pra Arbenita Murseli në vend të Shëndetësisë të jetë në Komitetin Për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport.

**Për Komitetin për zhvillim ekonomik dhe rural** e kemi Rifat Derin.

Faqe 38 nga 50

**Për Komitetin për Planifikim dhe Kadastër e Vesel Makolli.**

**Për Komitetin për Pronë e kemi Adelina Fazliji.**

Faleminderit.

**Kryesuesi**

Lëvizja për Bashkim Bukurie Canolli propozoj veten fuqishëm.

**Bukurie Canolli LB**

Pasi jam anëtarja e vetme nga LB atëherë unë propozoj veten Bukurie Canolli për Komitetin për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport.

**Kryesuesi**

Faleminderit.

Nga nisma.

**Baton Dushi - Nisma**

Edhe mua më mbeti ta propozoj veten.

**Kryesuesi**

Edhe Valbona Petrovci si e pavarur.

**Valbona Petrovci**

Përkundër faktit se jam anëtare e Komitetit për Komunitete, unë jam interesuar për anën ligjore se a ka ndonjë pengesë dhe kam shprehur gatishmërinë të jem anëtare e Komitetit për Arsim e Kulturë, sepse besoj se mund të jap kontribut se jam tridhjetë vite në arsim nëpër këto veprimtarit kulturore si kam shprehur vetë gatishmërinë.

**Kryesuesi**

Faleminderit shumë.

Atëherë e kemi listën të plotësuar me emra edhe ju lutem të bëhemi gati për votim.

Regjia gati.

Votojmë tash.

Atëherë me 39 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim konstatojmë se miratohet Propozim vendimi për themelimin e Komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Shkojmë në pikën e radhës.

**Pika e tetë**

**Propozim vendimi për miratimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2018**

**Kryesuesi**

Vazhdojmë me grupe parlamentare.

Në emër të LDK-s.

**Halim Halimi - LDK**

Grupi parlamentar i LDK-s është bërë nga Komisioni të cilët ne vet i kemi propozuar, unë vetëm e kam një vërejtje teknike. Faqe numër katër muaji shtator është informatë për mbarimin e vitit shkollor 2017/2018 dhe fillimin e vitit shkollor 2018/2019.

Në pikën tre e ke prapë Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor për 2018/2019, kështu që nuk ka nevojë kjo unë e kam thënë edhe në Komitet për Politikë dhe Financa, kjo pika tre fshihet.

Për ndryshe ne e përkrahim.

**Kryesuesi**

Faleminderit shumë.

Urdhëro Vala Peshku.

**Vala Peshku - GP**

Faleminderit kryesues.

Njëjtë pajtohem me z. Halimin sepse në KPF e kemi diskutuar dhe jemi për Planin vjetor të punës së Kuvendit të Komunës.

**Kryesuesi**

Faleminderit shumë.

Dikush prej grupeve tjera a dëshiron ta marr fjalën.

Urdhëro Vesel Makolli.

**Vesel Makolli - AKR - AA**

Fjalën ia jap Arbenita Murselit.

**Arbenita Murseli**

Faleminderit kryesues.

Propozimi ynë është që një pikë e rendit të ditës për seancën që do të mbahet në muajin Korrik që është Informatë për përfundimin e gjysmë vjetorit të vitit shkollor, testet e arritshmerisë dhe testet e maturës, meqenëse testi i maturës edhe i arritshmerisë do të mbahet në muajin maj, unë kërkoj që kjo pikë të del në seancën që do ta mbajmë në muajin maj, sepse duhet të jetë mësimi të mbahet atë muaj që të bëhen përgatitjet e duhura. Meqenëse testi i maturës nuk kalon çdo herë në mënyrën më të mirë të mundshme, çdo herë është proces kompleks dhe ka probleme andaj propozoj që kjo seancë të shtyhet më herët.

Po ashtu propozim tjetër është që në muajin Korrik të mbahen dy seanca edhe muaji Gusht të mos jetë pushim, të jetë pushim por edhe seanca e Gushtit të mbahet në Korrik.

Faleminderit.

**Kryesuesi**

Në rregull.

Po drejtori deshi një sqarim.

**Jonuz Salihaj - drejtor i Drejtorisë së Arsimit**

Unë besoj se testi i maturës mbahet në dy pjesë kështu që rezultatet shkojnë në qershor dhe testi i maturës, vlerësimi i maturës është pjesë përbërëse e vlerësimit të përgjithshëm të vitit mësimor.

Prandaj nuk do të mbahen dy seanca për këtë punë, prandaj propozimi është i pa pranueshëm.

**Kryesuesi**

Faleminderit shumë.

Dikush tjetër?

Atëherë e hedhim në votim.

Regjia gati të lutem.

Votojmë tash.

Atëherë me 41 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim miratohet Propozim vendimi për miratimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2018.

Shkojmë në pikën e radhës.



## **Pika e nëntë**

### **Propozim vendimi për shitjen e pronës së luajtshme të Komunës**

#### **Kryesuesi**

Atëherë shkojmë me grupe parlamentare.

#### **Halim Halimi - LDK**

Ne e përkrahim si vendim, d.m.th duhet të shiten veturat të cilat janë në parkun e veturave te Fushë Kosova.

#### **Kryesuesi**

OK, drejtori dëshiron të jap shpjegime.

#### **Muhedin Nushi**

Përshëndetje edhe njëherë.

Unë vetëm një shpjegim edhe njëherë shumë të shkurtër do të ju jap, i kemi pasur dy lista, d.m.th lista e parë është lista e automjeteve të cilat gjenden në tregun e automjeteve te ETC-ja në Fushë Kosovë. Nuk kemi ndales as nga Dogana as nga Policia për shtijën e atyre automjeteve e kemi d.m.th aprovimin e tyre.

Ndërsa listën e dytë plotësuese të cilën e keni marr janë automjetet të cilat kanë dal prej përdorimit ose janë në gjendje jo të rregullt dhe nuk kemi dëshiruar që të investojmë më tutje duke pasur parasysh se përmes autoritetit qendror të Prokurimit veç jemi furnizuar me 60 automjete të reja.

Prandaj e shoh shumë të arsyeshme që këto automjete të shiten dhe që këto mjete të cilat do ti inkasojmë që llogarit e tona të shkojnë deri në 110-120 mijë euro e ti destinojmë për qëllime të mirëqenies sociale.

#### **Kryesuesi**

Faleminderit drejtor.

Atëherë a ka nga grupet tjera.

Urdhëro Leonora.

#### **Leonora Shabani -Bajraktari**

Përshëndetje edhe njëherë.

LVV-ja e përkrah këtë vendim, sidomos po dihet destinacioni i këtyre mjeteve që do të drejtohen. Kështu që LVV-ja e përkrah vendimin.

#### **Kryesuesi**

Faleminderit shumë.

Diskutues të tjerë nuk janë paraqitur atëherë shkojmë me proces të votimit.

Regjia të lutem.

Gati për votim, votojmë tash.

Faleminderit.

Me 40 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim miratohet Propozim vendimi për shitjen e pronës së luajtshme të Komunës.

Shkojmë me pikën e radhës.

## **Pika e dhjetë**

### **Propozimvendimi për ndryshimin e vendimit për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa**

#### **Kryesuesi**

Lus përfaqësuesin e LVV-s që të jap propozimet.

#### **Vala Peshku - GP**

Grupi ynë i pavarur pasi që kemi biseduar Visare Gorani tërhiqet nga Komiteti për Politikë dhe Financa edhe lirohet një vend për Lëvizjen Vetëvendosje.

#### **Kryesuesi**

Faleminderit.

Urdhëro Leonora.

#### **Leonora Shabani -Bajraktari - LVV-s**

LVV-ja e propozon Eman Rrahmanin në KPF dhe Egzon Azemin. Është tërhequr Milot Podvorica.

#### **Kryesuesi**

Faleminderit shumë.

Atëherë e hedhim në votim këtë propozim.

Kush është për?

Atëherë me 31 vota për, 1 kundër dhe 6 abstenime miratohet propozimi për zëvendësimin e anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa, sipas emrave të propozuar.

Faleminderit.

Shkojmë në pikën e radhës.

## **Pika e njëmbëdhjetë**

### **Pyetje dhe përgjigje**

#### **Kryesuesi**

Urdhëro Kushtrim.

#### **Kushtrim Sopa**

Faleminderit kryesues.

Tash po dua me e ditur formën se qytetarët e lagjes "Arbëria" kanë filluar një peticion në secilën shtëpi për Qendrën e Mjekësisë Familjare për të shërbyer në shtatë ditë 24 orë.

Nuk po e di formën se ku duhet me e përcjell peticionin a duhet në drejtori apo vetëm me e sjell në Komunë si kërkesë.

Propozimi tjetër është se një grup i intelektualëve të cilët për emërimin e shkollës fillore në lagjen "Arbëria" ata po e propozojnë z. Mehmet Gjevorin, hartues i parë i Abetares në Kosovë, mësues nga Elbasani.

Kërkesë tjetër është kanalizimi te shkolla fillore "Elena Gjika" ose më konkretisht rruga "Ernest Koliqi", aty i ekspozohen fëmijët e shkollës çdo ditë atij kanalizimi dhe ujërave të zeza, që sigurisht është edhe rreziku nga epidemitë e ndrysmë të përhapen. Ky kanalizim është më shumë se gjashtë muaj aty.

Ndërsa edhe një kërkesë apo me e fut si rend të ditës një grup i të rinjve ka pruar një kërkesë por nënkryetari doli jashtë për një kompleks sportiv në hapësirën e lagjes

“Arbëria” ish “Cigllana”, ata po thirren në investimin nga UNDP-ia dhe Qeveria japoneze një investim 52 milion. Mua mu duk shumë atraktivë ky investim dhe pse mos me e marr e me shqyrtuar Kuvendi komunal. Ajo kërkesë paska ardhur në Komunën e Prishtinës nënkryetari qenka i informuar z. Selim Pacolli, edhe kisha pasur dëshirë me e pru si rend të ditës në Kuvendin komunal.

Faleminderit shumë.

### **Kryesuesi**

Faleminderit shumë.

Prej drejtorëve ka dikush që donë të përgjigjet dikush për pyetjet që u shtruan ku secili prej jush e gjeni veten tek pyetjet.

Urdhëro drejtor.

### **Muhedin Nushi**

Për peticion se kujt me ia drejtuar peticionin ia drejtoni Drejtorisë së Administratës, Zyrës së Kuvendit. Por edhe peticioni i ka rregullat e veta është qartë e shpjeguar në Statut dhe në Ligjin për Vetëqeverisje lokale. Nuk do të thotë se çdo peticion do të merret parasysh dhe të parashtrohet në rend të ditës të Kuvendit komunal te keni parasysh.

Janë qartë të definuara por e drejtoni në Drejtorinë e Administratës dhe te kryesuesi i Kuvendit.

### **Kryesuesi**

Faleminderit shumë.

Po drejtor urdhëro.

### **Jonuz Salihaj - drejtor i Drejtorisë së Arsimit**

Sa i përket emërtimit të shkollave unë besoj se ekziston një Komision që e bënë këtë punë, por unë posaçërisht pse mos të jam i interesuar me pasur shkolla emrin e Mehmet Gjevorit njeriut shumë të madh të arsimit pa asnjë dyshim nuk besoj se mundet askush me e kontestuar me asnjë element Mehmet Gjevorin, me bartë me nder çdo shkollë emrin e tij.

Unë besoj se është mëkat i madh që deri tani asnjë shkollë nuk e bartë emrin e Mehmet Gjevorit.

### **Kryesuesi**

Faleminderit shumë.

Prej drejtorëve dikush tjetër.

Urdhëro drejtor.

### **Arben Vitia - drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale**

Për informacionin e juaj nuk e di a e kam dhënë më herët më duket në asamblenë e mandatit të kaluar. QMF-ja në Arbëri ka mbyllur shërbimet gjatë vikendit për arsye se për shkak të rritjes së madhe të numrit të vizitave nëpër qendrat tjera. Ne kemi bërë një analizë ku në QMF në Arbëri gjatë vikendit nuk e ka kaluar numrin dhjetë të pacientëve. Kemi qenë të detyruar që një QMF tjetër që ka përmbi njëqind pacient gjatë kësaj kohe që të dërgojmë stafin shëndetësor atje.

Unë e kuptoj shqetësimin e lagjes “Arbëria”, mirëpo me këtë numër të vizitave edhe me këtë numër të punëtorëve shëndetësor që është nga viti 2005, edhe nuk është rritur fare pavarësisht që janë ndërtuar për këto 12 vite edhe QMF dhe Ambulanta. Ekziston numri i njëjtë i punëtorëve shëndetësor është e pa mundshme që të ju përgjigjem kërkesave të secilës lagje me shtim të shërbimeve edhe në ditë të caktuare.

Kjo ka qenë arsyeja.

Faleminderit.

**Kryesuesi**

Faleminderit shumë.

Dikush tjetër nuk ka.

Shefqet Osmani.

Më fal drejtor urdhëro.

**Gëzim Mehmeti - drejtor i Drejtorisë së Investimeve kapitale.**

Faleminderit.

Sa i përket pyetjes në lagjen Arbëria, ne kemi filluar me procedurat e tenderimit të një parku ku parashihen edhe fushat rekreativo- sportive do të thotë fushat e futbollit dhe fushat e basketbollit. Shpresoj se shumë shpejt do të përfundojnë procedurat e tenderimit dhe të fillojmë me ndërtimin e Parkut të ri në Arbëri.

Sa i përket pyetjes së juaj afër shkollës fillore "Elena Gjika", mi. Ne kemi intervenuar disa herë edhe pse nuk është kompetencë e jona në disa raste do të intervenojmë në "Elena Gjika", mirëpo duhet një projektim i ri duhet të shkojmë prapë me tenderim këtu.

Procedura e tenderimit po na merr shumë kohë dhe nuk po jemi në gjendje me reaguari shumë shpejt. Kjo është arsyeja se kur nuk po reagon ndonjëherë, por pastrimi është se mirëmbajtjen e ka kompetencë "KUR" Prishtina, kjo është arsyeja pse ne nuk po mundemi me reaguari shpejt.

**Kryesuesi**

Faleminderit shumë.

Urdhëro Shefqet Osmani.

**Shefqet Osmani**

Faleminderit kryesues.

Përshëndetje për të gjithë.

E kam një shqetësim dhe një pyetje për Drejtorin e Arsimit gjegjësisht për drejtorin që e kemi këtu.

Ne si Kuvend e patëm pasur një mbledhje të jashtëzakonshme për cilësinë e ajrit në Prishtinë dhe patëm debatuar, dhe një ndër qëndrimet që i kemi marr këtu si Kuvend për pyllëzimin dhe mbjelljen e drunjtëve dekorues në qytet për një ajër më të pastër.

Ndërkohë ky shqetësim dhe kjo ankesë vjen nga banorët e lagjes pranë shkollës "Asim Vokshi", nuk e di drejtori a është i informuar se drejtoresha e kësaj shkolle pa asnjë vendim, pa asnjë miratim ka prerë drunjtë bliri njëzet vjeçar të cilët kanë qenë prapa shkollës edhe e kanë bërë pastrimin e ajrit dhe filtrimin. Ata drunjtë i kanë mbjellë qytetarët të cilët jetojnë pranë shkollës.

Ky ka qenë një ekces shumë i madh edhe problem shumë i madh, nuk e di dhe nuk kam njohuri se a është dashur të formohet një Komision për vlerësimin e atyre drunjtëve për me i prerë, apo është dashur një diçka tjetër.

Drejtoresha ka paguar njerëz privat të cilët prenë dru me sharra për ti prerë ata drunjtë, është gjynah unë i kam videot dhe është tmerr se në çfarë gjendje kanë qenë të bukur e çfarë është sot.

Pse ka ndodhur nuk e di, prandaj kisha dashur një shpjegim prej drejtorit nëse është i informuar.

Faleminderit.

**Kryesuesi**

Faleminderit shumë.

Urdhëro drejtor.

**Jonuz Salihaj**

Faleminderit shumë.

E kam një informatë nga drejtoresha që .... ka konflikt me banorët afër aty për ata drunjtë, por informatë të detajuar nuk mundem të ju jap tani për tani, duhet me formuar një Komision dhe me e parë se çka ka ndodhur se informata është e frikshme do të thotë ka ndodhur për një kohë të shkurtër. Kështu që duhet me formuar Komisionin dhe me i parë detajet në të vërtet çka ka ndodhur në shkollën "Asim Vokshi".

Faleminderit.

**Kryesuesi**

Faleminderit shumë.

**Agim Gashi:** Kam disa pyetje për drejtorin e infrastrukturës: Çka po ndodhë me rrugën në lagjen Murtaj në Mramur? Nëse jeni në dijeni, në kontest për fillimin e ndërtimit të rrugës, është lidhur kontrata, për shkak të shpronësimeve atje ka një kontest, mirëpo duhet të gjendet një zgjidhje për banorë, sepse sipas informatave që i kam vetëm në 3-4 pika të asaj gjatësie 5 km e diçka, nuk mjafton sipërfaqja për zgjerimin e rrugës. Por aty ka gatishmëri që ata ta deklarojnë atë pronë si pronë publike, përmes procedurës së shpejtë, përmes noterit, si është ajo farë procedure ju e dini më mirë, por duhet ta kanë një përkrahje nga ana e juaj.

Pyetja e dytë: Cilat masa po i merr administrata e komunës për pengimin e hedhjes së mbeturinave nga konstrukcioni dhe demolimi në të gjitha pjesët e Komunës së Prishtinës? Pasi që siç e keni pa ju Fusha e Pajtimit ka filluar me u mbushur me mbeturina, kodrat e Hajvalisë gjithashtu, pjesa e Matit lartë në mal, gryka e Gollakut atje Mramori, Grashtica etj. etj. në Stallovë plotë mbeturina nga konstrukcioni dhe demolimi. Ne e dimë zgjidhjen cila është, por tash nuk është tema për me e hapë.

Pyetja e tretë: Pse inspektorati nuk po pengon ndërtimet pa leje, pasi 5 vjet është bërë zhurmë shumë e madhe për një gjë të tillë, kur plotë objekte në Komunën e Prishtinës në këtë periudhë dhe sot janë ndërtuar pa leje? Dhe po ashtu nuk po pengohet shfrytëzimi i hapësirave publike nga shërbimet e ndryshme afariste, dhe atë pa leje.

Dhe pyetja tjetër vijuese është: Kur do të vijnë 20 autobus të rinj që janë blerë nga Komuna e Prishtinës, dhe çfarë po ndodhë me ta?

Faleminderit.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë.

Gëzim Mehmeti.

**Gëzim Mehmeti:** Z. Gashi faleminderit për pyetjet.

Pothuajse është e pamundur me e ditur çdo kontest pronësor, por kemi vështirësi sa i përket realizimit të planit tonë, kur ka konteste pronësore. Në rast se ka gatishmëri të qytetarëve për me kaluar nga prona private në pronë publike, unë jam i gatshëm që sa më shpejtë të veprojmë që këtë rrugë ta asfaltojmë, apo varet se si është. Do të thotë në rast se

banorët, ne e kemi bërë me Drejtorinë e Pronës një marrëveshje publike e cila në një formë për arsye të ligjit, sepse është e kundërligjshme shtruarja me asfalt në prona private. Kjo nënkupton, po flasim me kubza, mundet përkohshëm, por në rast se qytetarët shprehin gatishmërinë, ne veprojmë menjëherë, dhe jam i gatshëm me juve në këtë kontest dhe absolut janë të mirëseardhur, unë i pres, për me u nënshkruar marrëveshja dhe me filluar menjëherë. U kry, jeni të mirëseardhur, do të thotë kur të doni nesër, pasnesër, ju presim.

**Kryesuesi:** Atëherë shkojmë.

Sami Boroci.

Për përgjigjet tjera po shohë që nuk janë këtu, po, po janë në procesverbal ato, normalisht që janë në incizim.

Në rregull.

Sami Boroci.

**Sami Boroci:** Faleminderit kryesues.

Atëherë dy kërkesa dhe një pyetje. Siç e përmendi Agim Gashi punën e ambientit, ose konkretisht e kam fjalën për lagjen "Dardania". I kam marrë disa kërkesa për një ambient që sipas banorëve aty, është shumë i papastër, edhe përkundër që këtë vit e kemi quajtur vit i ambientit dhe i pastrimit të Prishtinës. Ka pas edhe para dy javëve nëse nuk gaboju disa iniciativa të komunës, ose aktivitete që janë tentuar me u pastruar këto lagje, mirëpo ambienti vazhdon me mbet i papastër, po flas gjithmonë sipas banorëve, në lagjen "Dardania", po ashtu në pjesën e Veternikut, ose konkretisht te Fshati ndërkombëtar dhe ajo pjesa që shkon te Pallati i Drejtësisë. Edhe ajo është një, sidomos rreth rrugës që shkon edhe deri te banesat sociale në Hajvali, është një pjesë jashtëzakonisht e papastër dhe kjo vazhdon me mbetur pjesë e papastër, e kam pa edhe vetë këtë këto ditë. Kisha kërkuar prej drejtorisë përkatëse, që këtë problem me e trajtuar dhe me u munduar sa më shpejt me i pastruar këto pjesë.

Një diçka tjetër që ka të bëjë është që më herët e mora një kërkesë të qytetarëve, te udhëkryqi te Farmedi, pra, ka disa kërkesa të disa individëve, që me e bërë një zgjidhje, ose semafor ose rreth rrotullim, nuk po e di a ka komuna hapësirë me bërë diçka të tillë, mirëpo është kërkesë e qytetarëve të cilën desha me e adresuar.

Gjithashtu edhe një kërkesë për kryetarin, se nuk jam duke a pa qe disa seanca, Drejtoria e Parqeve kur ka me u krijuar, në seancat e kaluara kemi kërkuar që kjo drejtori ka qenë kërkesë e jona si asamble ose si GP i AKR-së, me u bë Drejtoria e Ambientit dhe Parqeve, ende nuk ka asnjë lëvizje, ende nuk ka kurrëgjë konkrete, po më intereson edhe po pres përgjigje sidomos për këtë pyetjen e fundit, prej kryetarit?

**Kryesuesi:** Faleminderit.

Adrian Berisha.

**Adrian Berisha:** Përshëndetje edhe njëherë.

Para disa javëve me iniciativën time personale si asamblist në Kuvendin Komunal, e kam iniciuar që me u zhvilluar Dita e tokës, ku dhurues të ndryshëm i kanë dhuruar diku rreth 712 drunj, dhe nga kjo foltore këtu e shfrytëzoj rastin me i kërkuar falje kolegut asamblist

publikisht për mënyrën se qysh iu kam qasur, kjo ka qenë periudhë shumë e vështirë për mua, pasi kam qenë shumë i ngarkuar. Arsyeja pse i kam shkruar në facebook, pikërisht ka qenë se kam dashur dhe kemi dashur së bashku me z. Isak Rakovicen të cilin e falënderoj për bashkëpunimin me mbjell drunj edhe në lagjen “Kodra e Trimave”, dhe unë e ftoj Emanin publikisht që së bashku me shkruar gjatë javës së ardhshme në “Hortikulturë”, ku mundemi me i siguruar diku rreth 50 drunj, dhe Emani së bashku me “Hortikulturën” me e gjet një vend në “Kodrën e Trimave”, edhe pse sipas “Hortikulturës” është mjaftë e vështirë, për arsye se si lagje është diku rreth 90% e betonuar fatkeqësisht. Pra po ashtu kur jemi te drunjt e bashkë ndjej shqetësimin e kolegut Shefqet Osmani, në lagjen “Ulpiana”, përkatësisht afër tregut janë prerë disa drunj nga qytetarët, d.m.th. qohet qytetari në ora 8:00 në mëngjes dhe thotë po më pengon druri dhe e prej. Kjo është jashtëzakonisht shqetësim, a po kupton, unë nuk e di çka duhet me bërë na si komunë, që këta qytetarë me i dënuar, d.m.th. unë mendoj personalisht që ne si komunë duhet me e menduar një formulë të dënimit. Edhe gjermanët, edhe suedezët edhe krejt, nëse ti ua mundëson atyre, edhe ata kanë me bërë shkelje të tilla, se edhe ata janë njerëz. Hajde ta shikojmë një mundësi, që nëse dikush e prenë një dru, me i shkruar një cek, një dënim prej...(Jashtë mikrofonit), po, qe perfekt, a e dini çfarë shqetësimi është, me pa drurin të prerë midis të lagjes kur kalon deri dje ka qenë d.m.th. nuk po e di për mua është tepër skandaloze.

Po ashtu d.m.th. bizneset e ndryshme në qytet, është hapur “Sarajeva” në Bregun e Diellit, rruga “B” edhe e qetë tymin e oxhakut midis banesave hej, d.m.th. asnjë banorë nuk po mundet më me jetuar qysh duhet, pra, e hapin dritaren, era e qebapit në gojë, a po dinë. Nuk po mundem me besuar që na si komunë po lejojmë, besomëni po, se unë prej se e mbaj në mend veten jetojë në “Dardani” afër “Bosnes” dhe ne jetojmë me atë erë dhe shpresoj që një ditë ka me marrë parasysh Drejtoria e Inspektoratit, edhe petitionin që e kemi bërë, që me i ndaluar bre, me ia qitur rregullat. Nuk jam kundër “Bosnes”, nuk jam kundër “Sarajevës” si biznes, sepse është korporatë, me diku rreth 300 punëtorë, por disa rregulla, a po e dinë, ti fiton. Ventilim, plus mundesh në ndërtesë me e kap ventilimin, ka mënyra, jemi duke jetuar në vitin 2018, plus bërlllogun afër shportës ku është, nuk po e di si po e quan drejtori Ismail Koka, shporta për cigare po më duket, shportat e vogla, me ua ndaluar biznesin bre, ti nuk mundesh me e lënë bërlllogun 10 kg në shportën e vogël, po e shëmton qytetin. Ti kalon sot te rruga “Luan Haradinaj” e ke bërlllogun, shumë e lehtë, po banorët, po hajde ta gjejmë ndonjë formulë.

Tjetra, unë si banor i lagjes “Dardania”, kur të dal prej hyrjes, nuk më intereson për flamurin atje, për këto gjëra, unë si banor kur e çeli derën më intereson me pas një dritë, më intereson me pas liftin, më intereson me pas pastër, OK drita u bë, lifti u bë, pastër. Korporatat “Interexi”, “Minimaxi”, “Meridiani”, krejt këto i gjuajnë fletushkat aty, ndotës të ambientit, hajde të bëjmë diçka bre, hajde të këqyrim ta gjejmë një formulë. I ke 10 biznese, hajde Komuna e Prishtinës, drejtoritë përkatëse, të punojmë, që ua bënë zotëri në fjalë hajde në një takim, nuk guxoni më me gjuajtur fletushkë, se për çdo fletushkë që e gjejmë, na kemi me të dënuar, ose ke me i mbjell 20 drunj, ke me bërë diçka, nuk shkon aty plus rrezikohemi. Qe shembull konkret, para disa javëve, kojshia im u kanë tu e rreh një djalë i cili paguhet 15 euro, ai nuk e mendon që ai tipi është i paguar prej korporatës atje, i merr 15 euro, çantën, gjynah, kurrfarë rregullash të punës, as nuk ia paguan p.sh. me atë

çantë prej 20 kg, as nuk e lajmëron, as nuk ka, a dinë mos të hyjmë d.m.th. se është katastrofë kjo.

Tjetra, sporti shkollor, Luljeta Shala më duket, qe dy muaj kërkoj prej Luljetës një takim për me e krijuar një ligë të basketit, një ligë të basketit e kam prej FBK-së. Luljeta Shala është shefe e Departamentit të sportit shkollor, qe dy muaj kërkoj takim, hajde së bashku ta bëjmë një ligë të basketit, mos të merren nxënësit me drogë, me krejt sendet që a dinë po merren, hajde ta bëjmë, ajo d.m.th. a ka mundësi cila është formula që ajo me ardhur këtu në Kuvend me na treguar se çka bënë për sportin shkollor? Kur e marrim parasysht që sporti është një prej formulave më të mira që rinjtë tanë mos me u marr me gjëra ilegale,

**Kryesuesi:** Ka përfunduar koha tash, 5 minuta.  
Urdhëro edhe 30 sekonda.

**Adrian Berisha:** Faleminderit.

Hajde d.m.th. të vjen ajo dhe na, se vëllai im është në klasën e tetë, hajde krejt na të mendojmë për të ardhmen. Këtë gruan e mbron, qysh e kam pa, paragjykim i imi, kjo d.m.th. bashkëpunon me një grua e cila së fundmi ka qenë në gjykatë, zonja Krasniqi ka qenë në gjykatë, dhe me Ligjin për Shërbimin Civil, ajo duhet me u suspenduar menjëherë prej punës, më sa e di unë, deri sa të kryhet d.m.th. komplet, menjëherë duhet me u suspenduar prej punës, unë vij, dhe ajo zonja është hala këtu në punë, dhe ti nuk mundesh me bashkëpunuar. I kam të gatshëm njerëzit që janë të etur për me e pa një ligë të basketit, një ligë të futbollit në shkollat e mesme, po dinë, janë të gatshëm gjithçka me dhuruar, d.m.th. tash veç edhe ka kaluar Ligji për sponzorizim të sportit dhe kulturës është në procedurë, dhe korporatat e kanë detyrimisht për me dhuruar, edhe është në interes të përbashkët.

Tjetra, sheshi i qytetit, unë kaloj në shesh të qytetit i gjej dy inspektorë të ulur në terasë e cila i ka qit karriget në mënyrë ilegale, d.m.th. edhe unë i them hej pse nuk po e dënoni, pse nuk po ia largoni, jo ky ka bërë investim 200.000 euro këtu, çka ma ndien që ka bërë investim 200.000 euro si qytetar. Unë dua me kaluar në shesh të qytetit me ecë lirshëm, mos me pa një shesh, nuk po e di është shesh skandalozë. Një ditë dalin kishe po e heqin boksën, boksi del ditën tjetër, edhe bamë aty mblidhen 30 veta, kalojnë motra ime, nënat tona, i ngucin, me fjalë të ndryshme. A ka mundësi me e gjete ndonjë formulë që sheshi i qytetit me kanë sheshi i qytetarëve, ku ka rregull, rend, harmoni, sepse është i vetmi atraksion përveç "Albit mall" që na mundemi me kaluar.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë.

Egzon Azemi, a deshi më fal drejtori

Egzon, Egzon më fal se drejtori duhet me u përgjigj diçka.

Regjia a ka mundësi Egzon Azemin me e futur në listë prapë?

Adrian, Adrian, të lutem tash edhe koha e pauzës veç po afrohet.

**Jonuz Salihu:** Adrian veç desha një arsytim për këtë Luljeta Shalën, kjo ka qenë në drejtori te unë, dhe ka kërkuar këto sallat që i kemi të shkollave më të mira këtu në Prishtinë. Ka kërkuar sallën e "Xhemail Mustafës", të cilën e kemi rinovuar, në të vërtetë e



ka rinovuar Ministria e Kulturës, ka investuar në atë dyshtemenë dhe tash dyshtemeja është me vibrim, nuk kemi mujt me ia dhënë atë sallë por e kemi quar në “Ali Sokol” dhe në “Ali Sokol” ajo ushtron dhe jo është e obliguar me iu përmbajtur këtyre rregullave, me bashkëpunuar me juve, sepse është sporti për fëmijë. Dhe nëse nuk bashkëpunon, ne ia ndalojmë mandej qasjen në shkollën “Ali Sokoli”. Unë tash nuk po marrë informata, ndoshta mundesh me më pajisur me informata, në mënyrë që ju të vazhdoni me bashkëpunuar, në mënyrë që të merr njëfarë jehone sporti shkollor, sepse kemi pak ngecje normalisht, e ka të obliguar, e ka të obliguar me bashkëpunuar nëse është udhëheqëse e sportit, ka me bashkëpunuar. Po ne i kemi krijuar kushte asaj pa para, nuk i marrim kurrfarë para, e ka sallën që e shfrytëzon.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë.

Egzon Azemi,

**Egzon Azemi:** Faleminderit kryesues.

Të falënderoj Adrianin që po i jep disa kritika në këtë rast edhe ndaj ekzekutivit, Adrianin më fal, se kështu duhet me qenë një asamblist, pa marrë parasysh a është me ekzekutivin, apo kundër, duhet me i shpreh edhe mangësitë edhe dobësitë e atij ekzekutivi.

Drejtor, drejtor, më iku drejtori apet. Pyetjen që e kamë bërë herën e kaluar, ka thënë që varrezat e dëshmorëve në Viti të Marecit, kanë me filluar punimet sa të përmirësohet koha, mirëpo këto punime ende nuk kanë filluar?

Drejtor mirë që u ktheve, një pyetje që e kam bërë edhe herën e kaluar kam marr përgjigje ke thënë që punimet në varrezat e dëshmorëve në Viti të Marecit kanë me filluar sapo të përmirësohet koha, mirëpo punimet realisht nuk kanë filluar ende, kjo është pyetja e parë? Pyetja e dytë, ose shqetësimi i dytë është nën kurriz disa vendkalime ku lidhen me shkollë, ku kalojnë fëmijët aty çdo ditë, ka rrjedhje të kanalizimit prej lokaleve që janë lartë, dhe është një problem shumë i madh ky. Kështu që besoj që është mirë me intervenuar sa më parë inspektorati apo kushdo që është përgjegjës për këtë çështje?

Desha edhe unë me i përmend ligat shkollore, se gjithashtu është premtim i kryetarit, mirëpo Adriani i dha vërejtjet me vend edhe për një person aty në Drejtori të Arsimit.

Tjetra është një pyetje për Planin rregullues në rrugën “Hysni Curri” në pjesën afër “Teatrit të Babës”, ka kërkesa nga qytetarët me e dit se a është gati Plani rregullues, në çfarë gjendje është, për shkak se qe një kohë të gjatë, kanë mbetur pa informacione lidhur me këtë çështje?

**Kryesuesi:** Faleminderit.

Drejtori Gëzim Mehmeti.

**Gëzim Mehmeti:** Egzon unë kisha pas dëshirë sot me filluar ndërtimin, po mendoj renovimin e varrezave të dëshmorëve në Viti të Marecit. Kryetari Shpend Ahmeti e ka nënshkruar do të thotë për fillimin e procedurave, jemi në procedura të tenderimit, besoj që shpejtë vendoset se cila kompani ka me e marr, sepse në një formë ne duhet ti respektojmë këto procedura, dhe në momentin që dihet kompania fituese, menjëherë do të fillojmë me ndërtimin dhe renovimin e varrezave të dëshmorëve. Dëgjo nëse ka qenë,

shiko vetëm një gjë, unë si drejtor i Drejtorisë për Investime Kapitale dhe Menaxhimin e Kontratave, unë duhet ti respektoj rregullat dhe procedurat, nuk mundem t'ia filloj me renovim apo sanim të varrezave, pa kaluar në procedurat e tenderimit, po më vjen shumë keq, por në momentin që të kryhen këto procedura, ne fillojmë. Janë shkuar në Zyrën e prokurimit dhe besoj që është shpallur, do të thotë është nënshkruar prej kryetarit.

**Kryesuesi:** Faleminderit shumë.

Atëherë kemi ardhur, ora është 13:15, është koha e pauzës, dhe kthehemi në orën 14:15, a jeni dakord? Me vazhduar me pyetje, me vazhduar me seancën? Mirë atëherë kush ka pyetje mundet me u kthyer, atëherë drejtorët i lus që të jenë këtu, ka pyetje. Jo atëherë pyetjet që janë, ju lutem i dërgoni me shkrim, po me shkrim për seancën tjetër, dhe e mbyllim këtu seancën.

Faleminderit shumë.

**Mbledhja përfundoi në orën 13:15.**